



Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E hënë, 23 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5069, datë 23.4.2014	Me objekt kërkesën për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine Bau” sh.p.k..... 3
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6678, datë 9.6.2014	Me objekt hapjen e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “Vila Park-Alb”, me seli në Tiranë, rruga “Hoxha Tahsim”, pallati “Vjero”, shkalla A..... 6
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 998, datë 17.6.2014	Me objekt çeljen e procedurës së falimentit..... 9
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 1141, datë 4.7.2014	Me objekt çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k..... 12
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 670, datë 25.7.2014	Me objekt shkarkimin nga detyra të administratorit të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k..... 16
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6718, datë 25.7.2015	Me objekt: Kërkohej shpallja e falimentit të shoqërisë “Certified Solutions Corporations” sh.p.k. me NUIS K82101016Q me seli të regjistruar në Mëzez, Kashar, Tiranë, pallati “Alb Konstruksion”, kati i parë, apartamenti 1, Fushë-Mëzez..... 18
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 670, datë 13.10.2014	Me objekt shkarkimin nga detyra e administratorit të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k..... 22
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 1596, datë 14.10.2014	Me objekt ndërprerjen e procedurës së falimentimit, të vendosur me vendimin nr. 996, datë 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë..... 24

Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 1758, datë 6.11.2014	Me objekt çeljen e procedurës së falimentit.....	26
Njoftim i ministrit të Kulturës nr. 1444, datë 20.3.2015	Për shpalljen e konkursit publik me objekt “Restaurimi i Kalasë së Gjirokastrës”	32



VENDIM

Nr. 5069, datë 23.4.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTAR: Ardian Kalia,

asistuar prej sekretares gjyqësore Beglie Nura, sot më datë 23.4.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që u përket palëve:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, e përfaqësuar në gjykim me autorizim të datës 5.4.2013, nga znj. Holta Merizaj.

Person i Tretë: Shoqëria “Alpine Bau” sh.p.k., me adresë: Rruga e Elbasanit, pallati “Gener 2”, kati i 3-të, Tiranë, e përfaqësuar në gjykim me autorizim nga av. Arben Kashahu, nr. 1089 licence, NIPT L 02205027 B, Anëtar i Dhomës së Avokatëve Tiranë, si dhe znj. Enida Sena, verifikuar identiteti me kartën ID nr. 031720281.

Përfaqësuesi ligjor i shtetit: Avokatura e Shtetit, në mungesë.

OBJEKTI: Kërkesë për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine Bau” sh.p.k.

Baza ligjore: Neni 104/c i ligjit 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008.

Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve ku, përfaqësuesja e palës kërkuese kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesja e personit të tretë kërkoi pranimin e kërkesës dhe çeljen e procedurave e falimentimit. Avokatura e Shtetit në mungesë, dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Se pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën me objekt dhe shkak ligjor si më lart, për çeljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k.

2. Siç rezulton nga ekstraktet e lëshuara nga QKR-ja, akte të cilat u administruan në gjykim, shoqëria “Alpine-Bad” sh.p.k. është një person juridik tregtar, subjekt i së drejtës tregtare

shqiptare, i krijuar dhe regjistruar konform ligjit të kohës në datën 13.7.2007, në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Në ekstrat është përcaktuar qartë selia e kësaj shoqërie: Rruga e Elbasanit, pallati “Gener 2”, kati i 3-të, Tiranë, e cila në vijim është ndryshuar me vendim të kësaj shoqërie, të regjistruar në QKR, në adresën e re: Rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 8, shkalla 3, kati i 5-të, apartamenti 8, Tiranë.

3. Kapitali themeltar: në vlerën 100.000,00 lekë. Objekti i veprimtarisë tregtare: “Kryerja e punimeve të ndërtimit të të gjitha llojeve (vepra arti), përfshirë ndërtimin e godinave dhe instalimeve të çdo lloji (vepra arti). Aktivitet kryesor tregtar dhe qiramarrja e qiradhënia e mjeteve të prodhimit dhe ndërtimit të të gjitha llojeve. Shitja dhe shpërndarja e elementeve prej betoni të armuar. Ndërmarrja e instalimeve elektrike dhe montimi i linjave elektrike. Mbajtja e raporteve të kontabilitetit për bizneset e ndërtimit. Dhënia me qira dhe marrja me qira e pasurive të paluajtshme. Zhvillimi i investimeve (kapitaleve) dhe realizimi i projekteve. Projektimi, planifikimi dhe sipërmarrja e ndërtimeve të kërkuara në lartësi dhe në thellësi, ndërtimi i tuneleve, sipërmarrjeve. Projektimi, planifikimi dhe sipërmarrja e ndërtimeve të duhura, të të gjitha llojeve të objekteve të artit dhe disenjove. Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve në përputhje me masat për mbrojtjen e mjedisit”.

4. Përfaqësues ligjor i shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k. është z. Manfred Karl Willi Deppe, me afat të emërimit të tij, nga data 28.6.2010 deri në datë 28.6.2015. Ortak i shoqërisë është shoqëria “Alpine Bau GmbH”, me kuotë pjesëmarrjeje në kapitalin e shoqërisë 100,00 pjesë, ose në masën 100%.

5. Sipas pohimeve të palës kërkuese, veprimtaria e shoqërisë ka rezultuar me humbje të kapitaleve tri vite rresht dhe konkretisht në vitet 2009, 2010, 2011, kjo për shkak të vështirësive financiare që ka kaluar ky subjekt tregtar. Ndodhur në këto kushte - sipas palës kërkuese-situata financiare e saj për shkak të humbjeve ekonomike, ka pas sjellë mbingarkesën e detyrimeve dhe paaftësi paguese të detyrimeve si ndaj shtetit ashtu edhe ndaj të tretëve. Gjendja financiare e përkeqësuar e parashtruar nga pala kërkuese ka diktuar dhe paraqitjen në gjykatë të



kërkesës së saj për hapje të procedurës së falimentimit në cilësinë e debitorit. Në bazë të nenit 3 dhe 4 të ligjit “Për falimentimin”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë/seksioni tregtar i saj është gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për hapje të procedurës së falimentimit.

6. Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin” (i ndryshuar) parashikon shprehimisht:

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak;

2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

3. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, paaftësia paguese në një të ardhme të afërt përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit.

4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë. Procedurat për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës.

5. Kriteret dhe mënyrat e përlllogaritjes së treguesve ekonomikë, mbi të cilët fillojnë procedurat e falimentimit, caktohen nga Këshilli i Ministrave”.

7. E drejta e palës kërkuese, për t’iu drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt: hapje të procedurës së falimentimit gjen mbështetje në nenin 14/1 të ligjit “Për falimentimin” sipas të cilit: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare”.

8. Në ligj bëhen rregullime të posaçme në varësi dhe të statusit (debitor apo kreditor) të subjektit që paraqet kërkesën për falimentimin. Në nenin 14 të ligjit “Për falimentimin” përcaktohet shprehimisht dokumentacioni i kërkuar nga ligji që duhet t’i bashkëngjitet kërkesës për hapjen e

procedurës së falimentimit, në rastin kur kërkesa parashtrohet nga organi tatimor, sikundër rasti konkret. Më konkretisht citojmë nenin 14.1/2 të ligjit:

“1/2. Organet tatimore përjashtohen nga pagimi i taksave gjyqësore. Për fillimin e procedurës së falimentimit organet tatimore paraqesin në gjykatë:

a) kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) dokumentacionin e shoqërisë (statutin, aktin e themelimit, numrin e NIPT-it);

c) bilancin me pasqyrat financiare të shoqërisë, për të cilën kërkohet fillimi i procedurës së falimentimit”.

9. Në rastin objekt gjykimi pala kërkuese, e paraqitur, bashkë me kërkesën për hapje të procedurës së falimentimit ka sjellë në gjykatë midis të tjerave dhe çka kërkohet në nenin 14 të ligjit: Pasqyrat financiare dhe bilancet e shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k., për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012. Në këto pasqyra financiare jepen pasuritë (inventarët e ndryshëm), përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra të debive dhe kredive etj.

10. Pala kërkuese në tërësinë e dokumenteve të paraqitura, ashtu sikurse parashtron në shpjegimet e saj, kërkon të provojë se plotëson kërkesat e ligjit “Për falimentimin”, duke parashtruar si shkak faktin se, personi i tretë ka rezultuar në mënyrë të pandërprerë me një bilanc ekonomik me humbje për më shumë se tri vite radhazi. Një fakt i tillë sipas palës kërkuese, dikton pamundësinë e personit të tretë për të marrë pjesë në vazhdim në qarkullimin civil si subjekt tregtar, kjo edhe për shkak të cenimit të interesave të ligjshëm të kreditorëve eventual të kësaj shoqërie e mbi të gjitha të shtetit. Ndër shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit, veç humbjeve në vijimësi, është insolvabiliteti apo gjendja e paaftësisë paguese të personit të tretë. Gjendja e paaftësisë paguese, nga pikëpamja e ligjit mbi falimentin, përbën një shkak të përgjithshëm dhe me të ligji lidh një nga mundësitë potencialisht të mjaftueshme për hapjen e procedurave të falimentimit.

11. Për të vlerësuar sa pretendon dhe parashtron pala kërkuese, pas paraqitjes dhe të dokumentacionit të kërkuar nga ligji, Gjykata vendosi, në përputhje me nenin 18 të ligjit “Për



falimentimin”, në relacion me nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, të emërojë një specialist ekspert, duke e ngarkuar me disa detyra në vështrim të asaj çka parashikon kjo dispozitë e ligjit të posaçëm mbi falimentimin. Gjykata caktoi si eksperte znj. Mimoza Mustafa Cara, e cila është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 13 licence datë 15.10.2012. Ekspertja Mimoza Mustafa Cara (Memoçi), pasi u njoh me të gjithë dokumentacionin e paraqitur në gjykatë nga pala kërkuese, në përputhje me ligjin në fuqi si dhe me detyrat e lëna, paraqiti një raport-vlerësimi, i cili iu nënshtrua hetimit gjyqësor. Në këtë raport-vlerësim përcaktohen detyrat e lëna dhe përgjigjet e pyetjeve në lidhje me to në mënyrë te detajuar.

12. Më konkretisht, sipas ekspertes së licencuar në fushën e administrimit falimentar, është konkluduar lidhur me detyrën e parë të caktuar nga Gjykata në vështrim të nenit 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” se:

“Në përfundim sa parashitrova me sipër, të dhëna tregojnë se shoqëria “Alpine Bau” Gmbh, Tiranë, ka qenë në humbje të kapitaleve të veta për periudhën 2009-2012 si dhe ne kushtet e paaftësisë paguese”. Në vijim të përgjigjeve të dhëna prej saj, detyrave të caktuara nga ana e Gjykatës në lidhje me shkakun e hapjes së procedurës së falimentimit, ekspertja ka konkluduar në akt se: “...të dhënat tregojnë se, me datë 31.12.2012 ka ekzistuar shkak real për hapjen e procedurës së falimentimit”. Ekspertja ka konkluduar gjithashtu edhe në lidhje me pamundësinë e vazhdimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë si për shkak të paaftësisë paguese, ashtu edhe për shkak të humbjeve ekonomike në më shumë se tri vite rresht. Në analizë të aktit të ekspertimit “Raport vlerësimi”, të hartuar nga ana e ekspertes Mimoza Cara, Gjykata konstaton se shoqëria, person i tretë në këtë gjykim, nuk ka mundësi për të gjenur të ardhura që mund të përmirësojnë treguesit e saj ekonomikë apo aftësinë paguese të saj. Në fund të raport-vlerësimit ekspertja përmbledh se ekziston shkak real për hapjen e procedurës së falimentimit, pasi vazhdimi i aktivitetit tregtar nga ana e shoqërisë është pothuajse i pamundur.

13. Ky konkluzion i ekspertes Mimoza Cara harmonizohet edhe me pohimet gjyqësore të palëve në gjykim. Nga ana e palës kërkuese, nëpërmjet përfaqësueses së saj të posaçme u pohua gjyqësisht fakti se shoqëria “Alpine Bau”

sh.p.k. duhet të çelte procedurat e falimentimit pasi për një periudhë për më shumë se tre vjet ka rezultuar me bilanc negativ në aktivitetin tregtar të saj, me humbje, ose në termat e ligjit, pasiv. E njëjta situatë faktike, paaftësia për të përmbushur detyrimet ndaj të tretëve e shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k., pamundësia për të vijuar normalisht aktivitetin e saj tregtar të ligjshëm, u pohua edhe nga përfaqësuesit e kësaj shoqërie, person i tretë në gjykim. Sipas pretendimeve të përfaqësueses së personit të tretë, në fazën e bisedimeve përfundimtare, vështirësitë e kësaj shoqërie në aktivitetin ekonomik të saj, burojnë edhe nga kriza e shoqërisë mëmë të saj (Holding) jashtë Shqipërisë, ndaj duhej vijuar me hapjen e procedurave falimentare në bazë të ligjit mbi Falimentimin në Republikën e Shqipërisë.

14. Nisur nga sa më lart, mbështetur në provat e paraqitura nga pala kërkuese dhe në raport-vlerësimin e ekspertes së falimentimit Mimoza Cara, Gjykata çmon se, në kushtet kur ekziston shkak real për hapjen e procedurës së falimentimit dhe plotësohen të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara në ligj, duhet të pranohet kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit duke pasur parasysh këtu dhe të gjitha kërkesat e ligjit, në lidhje me pasojat juridike të hapjes së procedurës së falimentimit dhe konkretisht: Caktimin e administratorit të falimentimit, publikimet përkatëse, të drejtat e kreditorëve të shoqërisë etj. Gjykata çmon të caktojë si administrator të falimentimit nga lista e eksperteve të licencuar në këtë fushë, znj. Shpresa Breçani, me nr. 9 license, datë 15.10.2012, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara- El”, shkalla e, ap. I, Tiranë.

15. Përfundimisht, për sa u argumentua më lart, duke e konsideruar të mbështetur në ligj e prova, Gjykata çmon të disponojë me pranimin e kërkesës për hapjen e procedurës së Falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, në bazë të ligjit nr. 8901 datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, si dhe në nenet 126 dhe 306 të Kodit të Procedurës Civile,



VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Hapjen në orën 11:45 të datës 23.4.2014 të procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k., me përfaqësues ligjor Manfred Karl Willi Deppe, me seli në Tiranë, rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 8, shkalla 3, kati i 5-të, apartamenti 8.
- Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k., znj. Shpresa Dem Breçani, eksperte kontabël e regjistruar, e licencuar në fushën e Administrimit të Falimentit me nr. 9 licence, datë 15.10.2012, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara- El”, shkalla e, ap. 1, Tiranë.
- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Alpine-Bau” sh.p.k. të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre, konform nenit 141 të ligjit 8901 datë 23.5.2002, i ndryshuar brenda 30 ditëve, nga dita e shpalljes së këtij vendimi.
- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Alpine-Bau” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.
- Personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë “Alpine-Bau” sh.p.k. duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit.
- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Alpine-Bau” për verifikim të mbahet brenda 50 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitimin e pretendimeve.
- Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k. duke i dërguar një kopje të tij Buletinit të Njoftimeve Publike.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k. t’i dërgohet Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me qëllim njoftimin për të gjitha ZVRPP-të dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901 datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.
- Një kopje e këtij vendimi gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-

Bau” sh.p.k. t’i dërgohet të gjitha Bankave të nivelit të dytë të RSh-së.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

- Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Alpine-Bau” sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe organit tatimor Tiranë.

- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të debitorit, shoqërisë “Alpine-Bau” sh.p.k..

- Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, i ndryshuar.

- U shpall në Tiranë, sot më datë 23.4.2014, ora 11:45.

Sekretare: **Beglie Nura**

Gjyqtar: **Ardian Kalia**

VENDIM

Nr. 6678, datë 9.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar, e përbërë nga gjyqtari i vetëm: Dritan Caka, asistuar nga sekretarja Luljeta Kazia, duke vepruar si Gjykatë e Falimentimit, në Tiranë, sot më 9.6.2014, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile nr. 9722 regjistri themeltar, që u përket palëve:

KËRKUESE: “Banka Alpha Albania” sh.a., person juridik shqiptar, me NIPT J 72311006 R, me seli në Tiranë, Rruga e Kavajës, Qendra e Biznesit “G-KAM”, kati i dytë, përfaqësuar me autorizim të posaçëm nr. 04391, datë 12.3.2014, av. Vangjel Kosta, me nr. 993 licence.

OBJEKTI: Hapjen e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “Vila Park-Alb”, me seli në Tiranë, rruga “Hoxha Tahsim”, pallati “Vjero”, shkalla A.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (me ndryshimet e mëvonshme).



Gjykata, pasi dëgjoi përfaqësuesin e palës kërkuese dhe të vetë debitorit “Vila Park-Alb” sh.p.k. që kërkuan pranimin e kërkesës, administroi provat dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Kërkuesi, shoqëria tregtare “Banka Alpha Albania” sh.a. është subjekt tregtar shqiptar, i cili ushtron aktivitet tregtar në fushën bankare.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes rezultoi se kërkuesi është kreditor ndaj debitorit, shoqëria tregtare “Vila Park-Alb” sh.p.k. Këtë cilësi si “kreditor”, kërkuesi e ka fituar për shkak të kontratave të kredisë bankare të cilat nuk janë ekzekutuar vullnetarisht prej kredimarrësit - shoqëria “Vila Park-Alb” sh.p.k. Shuma e detyrimeve ende të pashlyera të shoqërisë debitore ndaj kësaj banke aktualisht rezulton se është mbi 660 000 euro.

Për shkak të këtij mosekzekutimi, kërkuesi, pasi është pajisur me urdhrat përkatës të ekzekutimit, i është drejtuar ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve nëpërmjet shoqërisë përbarimore “Executores Litium” sh.p.k.

2. Gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, shërbimi përbarimor ka konstatuar se debitori nuk ka likuiditete për të përmbushur detyrimet në të holla sipas kontratave të kredisë - tituj ekzekutivë. Në këto rrethana, përbaruesi ka vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm për shitjen në ankand të pasurive të vëna në hipotekë.

Gjatë fazës së shitjes në ankand, ka rezultuar se sendet e vendosura si kolaterale (njësi pallati) për të garantuar shlyerjen e kredisë nga debitori “Vila Park - Alb” sh.p.k. u ishin premtuar shtetasve të ndryshëm, kundrejt kontratave të sipërmarrjes të lidhura ndërmjet këtyre shtetasve dhe debitorit.

Në këto kushte ekzekutimi i detyrueshëm mbi këto pasuri është pezulluar nga gjykatat mbi kërkesën e shtetasve që kanë lidhur kontratat e sipërmarrjes duke penguar kreditorin për të siguruar ekzekutimin e titujve të ekzekutimit, kontratave të kredisë.

Këto fakte provohen nga dokumentacioni i paraqitur prej palës kërkuese, përfshirë edhe vërtetimet e shoqërisë përbarimore “Executores Litium” sh.p.k., ku janë pasqyruar veprimet përbarimore të kryera me qëllim vënien në ekzekutim të titujve.

3. Në këto rrethana, nga ana e palës kreditore “Alpha Bank Albania” sh.a. është kërkuar që të hapen procedurat e falimentimit ndaj subjektit debitor, shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

Në kuadër të kërkesës së mësipërme për hapjen e procedurave të falimentimit për subjektin debitor, nga ana e shoqërisë kreditore (kërkuetit) është kërkuar paraprakisht që të merren masa të sigurisë, duke u caktuar një administrator i përkohshëm për debitorin, në bazë të nenit 21 të ligjit nr. 8901 “Për falimentimin”.

Kjo kërkesë u pranua nga gjykata me vendim të datës 16.4.2014, duke emëruar në këtë detyrë një nga administratorët e falimentimit të licencuar nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Falimentimit, e konkretisht znj. Elida Milo Miti (Dilo).

Kjo masë sigurie u vendos me qëllim që të parandalohet rëndimi i gjendjes ekonomiko-financiare të shoqërisë debitore, si dhe që të sigurohet mbarëvajtja e procesit të falimentimit.

4. Në vijim të shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, administratores së përkohshme të falimentimit iu ngarkuan detyrat e caktuara në nenin 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, ku përcaktohet: “*Gjatë shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të emërojë një specialist të veprorë si administrator i përkohshëm ose i ardhshëm i debitorit dhe i ngarkon atij këto detyra:*

a) të verifikojë nëse është real shkaku për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) të verifikojë nëse është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë;

ç) të verifikojë nëse është mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori?”.

Pas verifikimeve të kryera, nga ana e administratores së përkohshme të falimentimit iu paraqit gjykatës një raport fillestar, ku ishte arritur në konkluzionin se në shoqërinë “Vila Park-Alb” sh.p.k. kishte shkak real për hapjen e procedurës së falimentimit dhe se nuk ekzistonte mundësia për vazhdimin e aktivitetit të debitorit.

5. Ndërkohë, nga ana e gjykatës u thirr për t’u dëgjuar edhe pala debitore, shoqëria “Vila Park-Alb” sh.p.k., konkretisht e përfaqësuar nga administratori i saj, nga ana e të cilit u kundërshtua fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së



falimentimit. Kështu, nga ana e palës debitore u theksua se kjo shoqëri nuk është në kushtet e paaftësisë paguese dhe se ajo zotëron pasuri të tjera (njësi pallatesh) që mund të nxirren në shitje nga banka kërkuese, nëpërmjet shërbimit përmbartimor, me qëllim nxjerrjen e shumave për shlyerjen e kredisë.

6. Pasi dëgjoi debitorin, gjykata i kërkoi administratores së përkohshme të falimentimit që të verifikonte gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë, duke analizuar edhe pretendimet e parashtruara prej kësaj pale.

Në këto rrethana, nga administratorja e përkohshme e falimentit u paraqit një raport i dytë i rishikuar, ku rezultoi që ajo të ketë arritur në përfundimin se mungon shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. dhe se ekziston mundësia që kjo shoqëri të vijojë aktivitetin e saj, pasi ekziston mundësia e riorganizimit.

7. Në vijim të diskutimit të konkluzioneve të arritura nga administratorja e përkohshme e falimentimit, në seancën gjyqësore të ditës së sotme, pala debitore e ndryshoi qëndrimin e saj, duke kërkuar edhe nga ana e vet pranimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit. Konkretisht, nga përfaqësuesi i kësaj shoqërie u pranua se ajo (shoqëria) është në gjendjen e paaftësisë paguese, por ekziston mundësia e riorganizimit të saj, pasi të jetë hapur procedura e falimentimit.

8. Në rrethanat e mësipërme, gjykata arrin në përfundimin se duhet të pranojë kërkesën e kreditorit “Banka Alpha Albania” sh.a. dhe të vetë shoqërisë debitore “Vila Park-Alb” sh.p.k. për hapjen e procedurave të falimentimit të kësaj të fundit.

Konkretisht, gjykata e gjen kërkesën për hapjen e procedurave të falimentimit të kësaj shoqërie të mbështetur në kriteret e parashikuara në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Kështu, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të ligjit të mësipërm, gjykata konstaton se ekziston shkaku ligjor për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k., që është pikërisht gjendja e paaftësisë paguese të saj. Kjo gjendje vërtetohet nga fakti që shoqëria debitore nuk është në gjendje të paguajë detyrimet tashmë të maturuara ndaj bankës kërkuese.

Ekzistenca e gjendjes së paaftësisë paguese vërtetohet edhe nga raporti i paraqitur nga administratorja e përkohshme e falimentimit. Në këtë raport konstatohet se është arritur në konkluzionin se nuk ekziston shkaku real i hapjes së procedurave të falimentimit, vetëm duke u mbajtur në konsideratë fakti që ekziston mundësia e riorganizimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të debitorit. Në lidhje me këtë pikë, gjykata vlerëson se mundësia e vazhdimit të veprimtarisë së debitorit (ose riorganizimi i tij) duhet të verifikohet pasi të jenë hapur procedurat e falimentimit, ndërkohë që gjendja e paaftësisë paguese parashikohet nga ligji si shkak i parë dhe i mjaftueshëm në vetvete për hapjen e këtyre procedurave.

9. Pasi ka arritur në përfundimet e mësipërme, gjykata urdhëron edhe marrjen e masave të parashikuara në ligj për mbarëvajtjen e procedurave të falimentimit. Konkretisht, gjykata vendos që të emërojë si administratore të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. pikërisht znj. Elida Milo Miti (Dilo), që ka kryer deri tani detyrën e administratores së përkohshme të falimentimit. Nga ana tjetër, gjykata cakton afatet e përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi për paraqitjen e pretendimeve të kreditorëve pranë administratores së falimentimit dhe mbledhjen e kreditorëve, si dhe urdhëron publikimin e këtij vendimi në mënyrat e parashikuara në ligjin “Për falimentimin”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 13, 18, 26, 81 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën 14:45 të datës 9.6.2014 të procedurës së falimentimit të subjektit tregtar “Vila Park-Alb” sh.p.k. me NIPT K 32310001 P, me seli në Tiranë, rruga “Hoxha Tahsim”, pallati “Vjero”, shkalla A.

3. Emërimin si administratore të falimentimit për subjektin shoqëria “Vila Park-Alb” sh.p.k. të znj. Elida Miti (Dilo), e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 20 licence, me adresë: rruga “Komuna e Parisit”, pall. bankës “Credins”, kati i parë, pranë kompleksit “Kristal”, Tiranë.



4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. të paraqesin pranë administratores së falimentimit pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

5. Të gjithë kreditorët e subjektit huamarrës “Vila Park-Alb” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime të pashlyera nga shoqëria “Vila Park-Alb” sh.p.k. t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato nëpërmjet administratores së falimentimit.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. për raportim të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Në zbatim të nenit 81 të ligjit 8901 “Për falimentimin”, drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k., ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, kanë detyrë të njoftojnë për të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me procedurën e falimentimit, seksionin tregtar të gjykatës së rrethit, administratorin e falimentimit, komitetin e kreditorëve dhe të ndihmojnë administratorin e falimentimit për kryerjen e detyrës.

10. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. në Buletinin e Njoftimeve Publike.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

16. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë tregtare “Vila Park-Alb” sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. në dy gazeta me qarkullim kombëtar.

18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.

19. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall në Tiranë, sot më datë 9.6.2014.

Sekretare: **Luljeta Kazia**

Gjyqtar: **Dritan Caka**

VENDIM

Nr. 998, datë 17.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

Klodiana Gjyzari –gjyqtare,

asistuar nga sekretarja e seancës gjyqësore Esmeralda Ngucaj, sot më 17.6.2014, në Vlorë, në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim çështjen civile nr. 731, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria e Tatimeve dhe Taksave Vlorë, përfaqësuar nga znj. Aida Kume, zgjedhur me autorizim.

PERSON I TRETË: Shoqëria “Bravi Commerce” sh.p.k., me përfaqësues ligjor Vizhdan Brahimaj me seli: rruga “Demokracia”, l. Lirim pall. 6-katësh, kati iparë, nëmungesë.

OBJEKTI: Çelje e procedurës së falimentit.

BAZA LIGJORE: Nenet 13, 14 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, neni 104/1/c, i ligjit 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.



Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të zhvilluar në mungesë të personit të tretë, pasi dëgjoji përfaqësuesen e kërkuarit, e cila përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe pasi shqyrtoi provat;

VËREN:

Se kërkuari Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka paraqitur kërkesë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilën kërkon çeljen e procedurave të falimentit për shoqërinë tregtare “Bravi Commerce” sh.p.k. me pretendimin se kjo shoqëri për dy vjet me radhë ka nuk ka deklaruar të ketë pasur veprimtari tregtare.

Me kërkesë të kërkuarit, gjatë gjykimit u morën në shqyrtim provat shkresore, pasqyrat financiare të personit të tretë për tri vitet e fundit, si dhe u krye një akt ekspertimi në lidhje me verifikimin e objektit të kërkesës.

Gjykimi u zhvillua në mungesë të personit të tretë, i cili u njoftua nëpërmjet shpalljes, pasi nuk u bë e mundur njoftimi në rrugë të tjera.

Në përfundim të shqyrtimit të provave të kërkuara dhe marra në shqyrtim, gjykata çmon se rezultoi e provuar sa vijon:

Personi i tretë, shoqëria tregtare “Bravi Commerce” sh.p.k., është regjistruar më 9.5.2008 me NIPT (numër unik identifikimi i subjektit) K 86716207 P dhe administrator, përfaqësues ligjor, z. Vizhdan Brahimaj.

Në vitet ushtrimore 2011, 2012, nga pasqyrat financiare rezulton se kjo shoqëri nuk ka ushtruar veprimtari tregtare.

Për këtë shkak, kërkuari, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë i është drejtuar gjykatës, me qëllim çeljen e procedurave të falimentit për personin e tretë.

Gjykata çmon se bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar dhe nenit 104 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, kërkuari Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë legjitimohet të paraqesë kërkesën në gjykim.

Në nenin 104 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, parashikohet se:

Fillimi i procedurave të falimentimit

1. Administrata tatimore kërkon në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare:

a) 2 vjet pas kalimit në statusin pasiv nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

b) detyrimi tatimor i të cilëve është deklaruar i pambledhshëm;

c) që deklarojnë rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vite rresht;

ç) nuk kanë kryer veprimtari tregtare për një periudhë prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

d) kanë detyrime të pashlyera ndaj administratës tatimore prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

2. Tatimpaguesit, shoqëri tregtare, për të cilat administrata tatimore ka kërkuar fillimin e procedurave të falimentimit, publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Mosfillimi i procedurës së falimentimit të tatimpaguesve, shoqëri tregtare, brenda gjashtë muajve nga verifikimi i njërit prej kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nga nëpunësit e administratës tatimore, që verifikojnë apo kanë për detyrë të verifikojnë faktin juridik, përbën shkelje disiplinore.

Pra bazuar në nenin 104 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për procedurat tatimore” administrata tatimore ka detyrimin të kërkojë në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit, pasi personi i tretë nuk ka kryer veprimtari tregtare për një periudhë prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, objekti i të provuarit gjatë gjykimit të kërkesës për çeljen e procedurave të falimentimit janë:

Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të emërojë një specialist të veprave si administrator i përkohshëm ose i ardhshëm i debitorit dhe i ngarkon atij këto detyra:

a) të verifikojë nëse është real shkaku për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) të verifikojë nëse është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë;

ç) të verifikojë nëse është mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitorit.

2. Gjatë shqyrtimit të çështjes, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, mund të vendosë masa sigurimi mbi pasurinë e debitorit, sipas nenit 21 të këtij ligji.



3. Shqyrtimi i çështjes nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duhet të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkakat ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) rrëzimin e kërkesës për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit ose për rrëzimin e kësaj kërkesë, mund të bëhet ankim i veçantë nga debitorit ose kërkuesi për hapjen e procedurës së falimentimit.

Bazuar në nenin 18 të cituar më lart gjykata caktoi një ekspert falimenti nga akti i ekspertimit të të cilit rezultoi se shoqëria është e paaftë të paguajë detyrimet tatimore brenda afateve ligjore, dhe për tre vjet rresht konkretisht për vitet 2011, 2012, 2013 nuk ka ushtruar aktivitet. Shoqëria ka detyrime të prapambetura për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në shumën 99 838 lekë detyrim për tatimin mbi të ardhurat në shumën 4 556 lekë që prej vitit 2010 e në vazhdim.

Sipas tij ekziston shkaku real për fillimin e procedurave të falimentimit.

Pasuria e debitorit është e mjaftueshme për shlyerjen e procedurave të falimentit, pasi ka diferencë akti-pasiv, pozitive.

Nga aktet e paraqitura nga kërkuesi, pasqyrat financiare të vitit 2013 nuk janë depozituar dhe bilanci fiskal për vitin 2013 nuk është depozituar dhe nuk është e mundur të përcaktohet nëse është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë së debitorit.

Shoqëria nuk ka asnjë mundësi për vazhdimin e aktivitetit.

Kërkuesi kërkoi çeljen e procedurave të falimentit me pretendimin se një shoqëri që nuk ushtron aktivitet tregtar nuk ka arsye përse të ekzistojë.

Gjykata vlerëson se rastet kur gjykata vendos çeljen e procedurave të falimentit janë të parashikuara taksativisht dhe në nenin 19 janë të përcaktuara dhe rastet kur rrëzohet kjo kërkesë. Qëllimi i procedurës së falimentimit, siç

parashikohet dhe në nenin 2 të ligjit, është “1. Të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”

Gjykata, pasi mori në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesi pasqyrat financiare të debitorit, pasi verifikoi ato në përputhje me objektin e të provuarit në këtë lloj gjykimi nëpërmjet një eksperti, çmon se rezultoi që jemi para kushteve të parashikuara në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, në kushtet kur ekziston shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit dhe plotësohen të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara në ligj, duhet të pranohet kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.

Gjykata çmon të caktojë si administrator të falimentimit nga lista e ekspertëve të licencuar në këtë fushë, znj. Elpiza Rakip Gaxhazi, me nr.10 licence, me adresë: Rruga e Durrësit, sheshi “Karl Topia”, k. 3, ap. 9, L, P. Trema Engineering, Qendra e Biznesit, Tiranë, duke pasur parasysh këtu dhe të gjitha kërkesat e ligjit, në lidhje me pasojat juridike të hapjes së procedurës së falimentimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenin 104 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, i ndryshuar dhe nenin 126 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën 12:15 të datës 17.6.2014 të procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k., me përfaqësues ligjor Vizhdan Brahimaj, me seli në Vlorë, rruga “Demokracia” l. Lirim pallati 6-katësh, kati i parë, me NIPT K 86716207P.

3. Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. znj. Elpiza Rakip Gaxhazi, eksperte kontabël e regjistruar, e licencuar në fushën e Administrimit të Falimentit me nr. 10 licence, me adresë:

Rruga e Durrësit, sheshi “Karl Topia”, k. 3, ap. 9, L, P. Trema Engineering, Qendra e Biznesit, Tiranë.



4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Bravi-Commerce” sh.p.k. të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre, konform nenit 141 të ligjit 8901 datë 23.5.2002, i ndryshuar brenda 30 ditëve, nga dita e marrjes formë të prerë e këtij vendimi.

5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Bravi-Commerce” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë “Bravi-Commerce” sh.p.k. duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Bravi-Commerce” për verifikim të mbahet brenda 50 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitim e pretendimeve.

8. Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. duke i dërguar një kopje të tij Buletinit të Njoftimeve Publike.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me qëllim njoftimin për të gjitha ZVRPP-të dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

11. Një kopje e këtij vendimi gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. t’u dërgohet të gjitha Bankave të nivelit të dytë të RSH-së.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

14. Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Bravi-Commerce” sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, dhe organit tatimor Vlorë.

15. Shpenzimet gjyqësore me ngarkim të debitorit shoqërisë “Bravi-Commerce” sh.p.k.

16. Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë.

Sekretare: **Esmeralda Ngucaj**

Gjyqtare: **Klodiana Gjyzari**

VENDIM

Nr. 1141, datë 4.7.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

Herila Çela – gjyqtare,

asistuar nga sekretare gjyqësore Ilda Prifti, sot më datë 4.7.2014, përfundoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr. 714, datë 6.1.2014, që i përket:

KËRKUESE: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë e përfaqësuar me autorizim nga znj. Aida Kume.

PERSON I TRETË: Shoqëria “Lamaj” sh.p.k. me adresë: lagjja “Hajro Çakerr”, nr. 99, Vlorë (në mungesë, njoftuar me shpallje).

OBJEKTI : Çelje e procedurës së Falimentimit për Shoqërinë.

BAZA LIGJORE: Nenet 13 pika 2, 14 e vijues të ligjit nr. 8901 datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, neni 104 pika 1/c i ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata në përfundim të gjykimit, pasi mori në shqyrtim provat shkresore,

dëgjoi palën kërkuese që përfundimisht kërkoi:

Pranimin e kërkesës në tërësi; shqyrtoi provat shkresore që ndodhen në dosje, si dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me anë të kërkesës - objekt gjykimi për të kërkuar çeljen e procedurës së falimentimit.

Duke qenë se ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje e cila ka si objekt të sajin çeljen e procedurës së falimentimit në bazë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstaton se çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e saj. Duke qenë se ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje e cila ka si objekt të sajin çeljen e procedurës së falimentimit në bazë të nenit 36 të



Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstaton se çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e saj. Lidhur me kompetencën tokësore Gjkata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje duke qenë se debitori e ka selinë në qytetin e Vlorës. Kompetenca tokësore për gjykimin e kësaj mosmarrëveshje argumentohet edhe me qëndrimin mbajtur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 36, datë 26.1.2010 në të cilin sqarohet se: “Neni 13 dhe, posaçërisht, neni 14 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, parashikojnë të drejtën e organeve tatimore për të kërkuar në gjykatë fillimin e procedurave të falimentimit nëse personi juridik rezulton me një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare. Këtë të drejtë të administratës tatimore e parashikon edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”.

Për sa i përket kompetencës lëndore, asaj tokësore dhe për formimin e gjykatës së falimentimit, krahas parimeve të përgjithshme të parashikuara në nenet 35, 42, 43 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, rregullat e posaçme janë caktuar në dispozitat e ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”. Në nenin 3, pika 1 e këtij ligji përcakton kompetencën lëndore, duke parashikuar se: “Realizimi i procedurave të falimentimit është detyrë e seksioneve tregtare të gjykatës së rrethit (gjykata e falimentimit)”. Ndërsa në pikën 2 parashikohet përbërja e gjykatës së falimentimit. Sipas kësaj pike, shqyrtimi i çështjes “bëhet nga një gjyqtar i vetëm”.

Neni 4 i këtij ligji, në harmoni me parimet e përgjithshme procedurale civile të lartpërmendura, përcakton kompetencën territoriale për shqyrtimin e kërkesës për fillimin e procedurave të falimentimit. Në pikën 1 parashikohet se kjo procedurë “... shqyrtohet dhe gjykohet në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori, i cili është person juridik, ka vendbanimin ose selinë”. Pikat e tjera të këtij neni, si dhe nenet 5 deri 8 të këtij ligji, rikonfirmojnë kompetencën territoriale të lartpërmendur dhe zgjidhjen e situatave të posaçme të transferimit të selisë së personit juridik, procedurës së ankimimit etj.

Ligjvënësi, me anë të një amendamenti të kryer me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, ka vendosur të shtojë pikën 3, pas pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, me këtë

përmbajtje: “Shqyrtimi i çështjeve duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksioni tregtar”. Duke shqyrtuar përmbajtjen e këtij amendamenti, që duket të tregojë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksioni tregtar, si gjykatë kompetente, përveç pasaktësive e paqartësive teknike, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstaton edhe një kundërshti të hapur të përmbajtjes së saj, jo vetëm me dispozitat e përgjithshme procedurale mbi kompetencën tokësore të Kodit të Procedurës Civile, por edhe me vete rregullimet ezauruese të dispozitave të posaçme për këtë qëllim të neneve 4 deri 8 të të njëjtit ligj, ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”. Nisur nga sa më sipër, Kolegji Civil çmon se është në misionin e gjykatës që të shqyrtojë dhe zgjidhë çështjen në gjykim, edhe nëse gjatë shqyrtimit të saj konstaton se “ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë” (neni 1 i Kodit të Procedurës Civile). Edhe në çështjen-objekt gjykimi, kundërthëniet në ligj janë të dukshme. Ndonëse ka edhe paqartësi, amendamenti i vitit 2008 tregon si gjykatë kompetente tokësore atë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kundërshti me të gjitha dispozitat e tjera të vetë ligjit të posaçëm me nr. 8901, datë 23.5.2002, pa përmendur këtu rregullat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile, mbi kompetencën tokësore kur subjekt është personi juridik (neni 43). Të gjitha këto dispozita në harmoni me njëra-tjetrën i përmbahen parimit të mirënjohur të caktimit të gjykatës kompetente në vendbanimin e të paditurit dhe, nëse është person juridik, në vendin ku ndodhet selia e tij. Për raste të veçanta, përjashtimore, në varësi të natyrës e llojit të padisë, apo kërkesës objekt shqyrtimi, ligjvënësi, si në Kodin e Procedurës Civile, ashtu edhe në ligje të posaçme, parashikon edhe zgjidhje të posaçme për caktimin e kompetencës tokësore. Prandaj, nëse në ligje të ndryshme, apo brenda të njëjtit ligj, përmbahen dispozita që, në kundërshti me njëra-tjetrën, parashikojnë zgjidhje të ndryshme lidhur me kompetencën lëndore a tokësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të së njëjtës natyrë, në parim, gjykata që shqyrton çështjen, kur nuk konstaton ndonjë qëllim a vullnet të qartë përjashtimor në vetvete të normës kundrejt normave të tjera të posaçme, i përmbahet atij rregullimi i cili është në harmoni me vetë frymën e qëllimin e ligjit të posaçëm, si dhe me parimet e përgjithshme



procedurale për caktimin e gjykatës kompetente në rendin juridik shqiptar, gjithnjë në funksion të parashikimit të mjeteve efektive dhe sa më eficiente për t'iu drejtuar gjykatave dhe për dhënien e drejtësisë.

Për shqyrtimin e kërkesave për falimentim, gjykata duhet të zbatojë parimet e përgjithshme dhe rregullat e posaçme e të hollësishme mbi kompetencën tokësore të seksioneve tregtare të gjykatave të rretheve gjyqësore, ku ndodhet selia e personave juridike debitorë.” Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është kompetente për gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje. Gjykimi u zhvillua në mungesë të personit të tretë, shoqëria “Lamaj” sh.p.k., pasi megjithëse u konfirmua njoftimi nuk u paraqitën në gjykim.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se sipas ekstraktit historik të regjistrit tregtar i lëshuar nga QKR-ja, shoqëria “Lamaj” sh.p.k. është një person juridik tregtar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, subjekt i së drejtës tregtare shqiptare, i regjistruar në datë 27.4.2007.

Në ekstrakt është pasqyruar se kjo shoqëri ka objekt veprimtarie: Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimor, lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse, import eksport etj. Kapitali themeltar i shoqërisë “Lamaj” sh.p.k është në vlerën 100.000,00 lekë dhe kohëzgjatja e saj është përcaktuar me afat të pacaktuar. Shoqëria figuron me status pezulluar. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka kërkuar fillimin e procedurës së falimentimit të kësaj shoqërie duke parashtruar se sipas të dhënave të saj ky subjekt nuk ka realizuar veprimtari tregtare.

Arsyetim Ligjor

Ligji nr. 8901 i ndryshuar me ligjin nr. 9919 datë 19.5.2008 “Për falimentimin” rregullon rastet e çeljes së procedurës së falimentimit si dhe procedurën përkatëse.

Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

Ligji parashikon kushte specifike për subjekte që i nënshtrohen kësaj procedure si dhe për kushtet thelbësore që duhet të përmbushë veprimtaria e

këtyre subjekteve që të konsiderohet e përshtatshme për të nisur procedurën e falimentimit.

Procedura e falimentimit mund të hapet për pasuritë e çdo personi, fizik ose juridik, si dhe për pasuritë e shoqërive të thjeshta ndërkohë që nuk mund të hapet për pasurinë e shtetit ose të një organi të tij.

Shoqëria “Lamaj” sh.p.k. është një person juridik i organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Për pasojë veprimtaria e saj mund të jetë objekt i një procedure falimentimi.

Sipas nenit 16 të ligjit nr. 8901 i ndryshuar me ligjin nr. 9919 datë 19.5.2008 “Për falimentimin”:

“Të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor, anëtarët e organit drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka kërkuar çeljen e procedurës së falimentimit duke u mbështetur në nenin 104 të ligjit “Për procedurat tatimore” sipas të cilit:

“1. Administrata tatimore kërkon në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare:

a) 2 vjet pas kalimit në statusin pasiv nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

b) detyrimi tatimor i të cilëve është deklaruar i pambledhshëm;

c) që deklarojnë rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vite rresht;

ç) nuk kanë kryer veprimtari tregtare për një periudhë prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

d) kanë detyrime të pashlyera ndaj administratës tatimore prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

2. Tatimpaguesit, shoqëri tregtare, për të cilat administrata tatimore ka kërkuar fillimin e procedurave të falimentimit, publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Mosfillimi i procedurës së falimentimit të tatimpaguesve, shoqëri tregtare, brenda gjashtë muajve nga verifikimi i njërit prej kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni,

nga nëpunësit e administratës tatimore, që verifikojnë apo kanë për detyrë të verifikojnë faktin juridik, përbën shkelje disiplinore.”

Pra Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka legjitimitetin aktiv për të kërkuar hapjen e një



procedure falimentimi, në bazë të nenit 104 të ligjit “Për procedurat tatimore”. Në bazë të ligjit të sipërcituar procedura e falimentimit hapet për pasuritë e çdo personi, përfshirë dhe atë juridik, siç është kërkesa në rastin konkret objekt gjykimi dhe përpara se të jetë kryer ndarja e pasurisë (në rastet e prishjes së shoqërisë dhe futjes së saj në likuidim).

Në nenin 15 të ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht dhe dokumentacioni që kërkohet të paraqitet bashkëngjitur kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në nenin 13/1 të ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.”

Më tej në pikat e tjera të kësaj dispozite ligjvënësi përcakton në mënyrë të shprehur se kush janë shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit, duke mos lënë vend për interpretime apo vlerësime nga ana e gjykatës në lidhje me shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit. Këto shkaqe janë:

-“Gjendja e paaftësisë paguese” e cila është shkak i përgjithshëm dhe ligji jep nocionin e kësaj “gjendjeje paaftësie paguese”;

-“Mbingarkesa me borxhe” e cila përbën shkak hapje të procedurës së falimentimit vetëm për personin juridik (pra jo për çdo subjekt). Dhe në lidhje me këtë shkak ligji jep nocionin e plotë të “mbingarkesës me borxhe”.

Pala kërkuese paraqiti si shkak për kërkimin e saj mbi hapjen e procedurës së falimentimit gjendjen e paaftësisë paguese dhe mbingarkesën me borxhe të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k. Për të verifikuar dhe vlerësuar pretendimet e palëve në gjykim, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe atë të kërkuar nga ligji, gjykata vendosi në përputhje me nenin 18 të ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” kryerjen e një akti ekspertimi kontabël.

Nga akti i ekspertimit rezultoi se:

“...Sipas situatës financiare të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k., shoqëria është e paaftë që të paguajë detyrimet tatimore brenda afateve ligjore. Shoqëria “Lamaj” sh.p.k. sipas ekstraktit historik të QKR-së ka statusin pezulluar që prej shtatorit të vitit 2013. Pra shoqëria ka mbi 1 vit në statusin pasiv nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Shoqëria “Lamaj” sh.p.k sipas situatës financiare në DRT ka detyrime të prapambetura prej 2012 për TAP, sigurime shoqërore dhe TVSH në shumën 228.778 lekë, detyrim për tatimin gjithashtu ka borxhe të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2013 prej të paktën 230000 lekë. Pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Pra kishte mundësi për vazhdimin e veprimtarisë nga debitori..”

Nisur nga sa u argumentua, u përshkrua më lart, mbështetur në provat e paraqitura, gjykata vlerëson se në kushtet kur ekziston shkak real për hapjen e procedurës së falimentimit dhe plotësohen të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara në ligj duhet të pranohet kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k.

Neni 18 i ligjit nr. 8901 i ndryshuar me ligjin nr. 9919 datë 19.5.2008 “Për falimentimin” i jep gjykatës tri opsione vendimmarrjeje të cilat janë :

“a) rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkakut ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) rrëzimin e kërkesës për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.”

Në nenin 19 kushti i provueshmërisë së mundësisë së debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit ritheksohet:

“Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit kur vërtetohet se pasuria e debitorit është e pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit, përveç kur kërkuesi parapaguan një shumë të mjaftueshme, sipas çmimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.”

Në rastin konkret u vërtetua se pasuria e debitorit është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit, e për pasojë gjykata çmon se kërkesa për çeljen e procedurës së falimentimit duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Në bazë të neneve 306 dhe 309 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ligji nr. 8901 i ndryshuar me ligjin nr. 9919 datë 19.5.2008 “Për falimentimin” gjykata



VENDOSI:

-Pranimin e kërkesës.

- Çeljen e procedurës së falimentimit sot në ora 09:15, datë 4.7.2014, të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k., të regjistruar me Vendimin nr. 38109, datë 24.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Vlorë, lagjja “Hajro Çakerri”, nr. 99.

- Caktimin si administrator të falimentit të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k., z. Rrapo Xhaferi dhe heqjen e debitorit, shoqëria “Lamaj”, të së drejtës së administrimit dhe disponimit të pasurisë së saj.

- Kreditorëve të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k. u kërkohet të paraqesin tek administratori i falimentimit pretendimet e tyre brenda një afati 90 ditor si edhe të drejtat e siguruara, nëse ka, mbi pasuritë e debitorit duke dhënë të dhëna të hollësishme për sendin mbi të cilin pretendohet e drejta e siguruar, natyrën dhe shkaku e lindjes së të drejtës së siguruar dhe për pretendimet e siguruara.

- Personat që kanë detyrime ndaj debitorit duhet t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratorit të falimentimit.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k. për raportim të mbahet brenda 60 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Lamaj” sh.p.k. për verifikim të mbahet brenda 50 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitimin e pretendimeve.

- Të kryhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k., duke i dërguar një kopje të tij Buletinit të Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k. t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me qëllim njoftimin për të gjitha ZVRPP-të Vendore.

- Një kopje e këtij vendimi gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k. t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të R.Sh-së.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

- Të kryhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Lamaj” sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të debitorit, shoqërisë “Lamaj” sh.p.k.

- Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

U shpall sot më datë 4.7.2014 në Vlorë.

Sekretare: **Lorena Grabova**

Gjyqtare: **Herila Çela**

VENDIM

Nr. 670, datë 25.7.2014

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË ADMINISTRATORIT TË FALIMENTIMIT PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar, e përbërë nga gjyqtari i vetëm: Dritan Caka,

asistuar nga sekretarja Luljeta Kazia, duke vepruar si Gjykatë e Falimentimit, në Tiranë, sot më 25.7.2014, mori në shqyrtim çështjen civile që i përket:

KËRKUESE: Znj. Elida Miti (Dilo) – Administratore Falimenti, me adresë: rruga “Komuna e Parisit”, pall. bankës “Credins”, kati i parë, pranë kompleksit “Kristal”, Tiranë.

Persona të tretë: 1. “Banka Alpha Albania” sh.a., person juridik shqiptar, me NIPT J72311006R, me seli në Tiranë, Rruga e Kavajës, Qendra e Biznesit “G-KAM”, kati i 2-të, përfaqësuar me autorizim të posaçëm nga av. Vangjel Kosta.

2. Shoqëria tregtare “Vila Park-Alb” sh.p.k., me NIPT K32310001P, me seli në Tiranë, rruga “Hoxha Tahsim”, pallati “Vjero”, shkalla A, me cilësinë e palës debitore në procedurën e falimentimit, e përfaqësuar nga administratori i saj Arben Ismailaga dhe av. Artjon Beqiraj, me autorizim të posaçëm.



OBJEKTI: Shkarkimi nga detyra e administratorit të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 46 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Gjykata, pasi dëgjoi administratoren e falimentit dhe përfaqësuesit e personave të tretë të interesuar në seancë gjyqësore,

VËREN:

1. Me vendimin nr. 6678, datë 9.6.2014 të kësaj gjykatë është vendosur hapja e procedurave të falimentimit për subjektin tregtar “Vila Park-Alb” sh.p.k. Ky vendim është marrë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kreditori “Banka Alpha Albania” sh.a.

Me të njëjtin vendim është emëruar znj. Elida Miti (Dilo) si administratore e falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

2. Me kërkesën objekt shqyrtimi administratorja e falimentimit e shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. ka kërkuar që të shkarkohet nga kjo detyrë, për shkak të vështirësive që ka hasur në këtë proces, si pasojë e mungesës së bashkëpunimit të debitorit dhe mungesës së likuiditeteve.

Këtë kërkesë administratorja e falimentimit e mbështet në nenin 46 të ligjit nr. 8901 “Për falimentimin” (i ndryshuar), ku parashikohet:

“1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të shkarkojë nga detyra administratorin e falimentimit për arsye të motivuar. Shkarkimi mund të bëhet me kërkesën e vetë administratorit të falimentimit, me kërkesën e komitetit të kreditorëve ose të mbledhjes së kreditorëve. Përpara marrjes së vendimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon shpjegimet e administratorit të falimentimit.

2. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për shkarkimin e tij, administratori i falimentimit ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për rrëzimin e kërkesës për shkarkimin e administratorit, kanë të drejtën e ankimit të veçantë administratori i falimentimit, komiteti i kreditorëve ose kur propozimin për shkarkimin e tij e ka bërë mbledhja e kreditorëve, çdo kreditor falimentimi.”

3. Pas paraqitjes së kërkesës së znj. Elida Miti (Dilo) për shkarkimin nga detyra, gjykata caktoi seancën gjyqësore për marrjen në shqyrtim të saj, duke thirrur edhe përfaqësuesit, kreditorit “Alpha Bank” sh.a. (që ka kërkuar hapjen e procedurës së

falimentimit) dhe debitorit “Vila Park-Alb” sh.p.k.

Të dyja këto subjekte, pasi u njohën me kërkesën e administratores së falimentimit dhe shpjegimet e saj në seancë gjyqësore u shprehën dakord me zëvendësimin e saj nga një administrator tjetër falimentimi.

4. Në këto rrethana, gjykata vlerësoi se kërkesa e administratores së falimentimit Elida Miti (Dilo) duhet të pranohet, duke u bërë zëvendësimi i saj me një administrator tjetër të licencuar.

Për këtë qëllim, pasi u konsultua lista e administratorëve të falimentimit e publikuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentimit (AMF), si dhe pasi u mor mendimi i palëve, gjykata vendosi të caktojë si administrator të ri të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k., z. Rezar Selahedin Llukaçej, i cili dha edhe pëlqimin përpara gjykatës për ta marrë përsipër këtë detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Zëvendësimin e znj. Elida Miti (Dilo) caktuar në detyrën e administratores së falimentimit të subjektit shoqëria “Vila Park-Alb” sh.p.k., me z. Rezar Selahedin Llukaçej, licencuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 1 licence, me adresë: rruga “Margarita Tutulani”, pall. “Alb. Millenium”, katë 1 e 2-të, përballë Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë.

2. Urdhërohet administratorja e falimentimit znj. Elida Miti (Dilo) që t’i dorëzojë administratorit të falimentimit të caktuar rishtazi z. Rezar Selahedin Llukaçej të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e tjera të grumbulluara deri në fazën aktuale të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

3. Urdhërohet dërgimi i një kopjeje të këtij vendimi të gjithë subjekteve të përcaktuara në vendimin nr. 6678, datë 9.6.2014 i kësaj gjykatë për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

4. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në të gjitha format me të cilat është publikuar vendimi nr. 6678, datë 9.6.2014 i kësaj gjykatë për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.



U shpall në Tiranë, sot më datë 25.7.2014.

VËREN:

Sekretare: **Luljeta Kazia**

Gjyqtar: **Dritan Caka**

VENDIM

Nr. 6718, datë 25.7.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

GJYQTAR: Arjan Aliaj,

asistuar prej sekretare gjyqësore Denisa Xhafa, sot në datë 25.7.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen civile nr. 6718 akti, që u përket palëve,

KËRKUES: Qirjako Kongoli, i biri i Koço, i ditëlindjes 9.4.1953, lindur në Këlcyrë, Përmet e banues në Tiranë, përfaqësuar në gjykim me prokurë të përgjithshme nr. 1404 rep dhe 588 kol datë 26.11.2003 nga av. Bashkim Asllani dhe Dsorina Ndreka.

PERSON I TRETË: Shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k. me seli: Mëzez, Kashar, Tiranë, pall. “Alb Konstruksion” kati i parë, ap.1, Fushë-Mëzez përfaqësuar në gjykim nga përfaqësuesi ligjor Venigjar Begaj dhe av. Emin Saraçi (në mungesë).

Batjon Begaj i biri i Venigjar i dtl. 18.10.1991, banues në Tiranë, rruga “Komuna e Parisit” pall.4, ap.9, përfaqësuar në gjykim me prokurë të përgjithshme nr.1373 rep dhe 389 kol datë 30.12.2010 nga Monika Begaj dhe av. Emin Saraçi (në mungesë).

OBJEKTI: Kërkohet shpallja e falimentit të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k. me NUIS K 82101016Q me seli të regjistruar në Mëzez, Kashar, Tiranë, pall. “Alb Konstruksion” kati i parë, ap.1, Fushë-Mëzez.

Caktimi i administratorit të përkohshëm të falimentit.

BAZA LIGJORE: Nenet 334 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 8901 datë 23.5.2002 “Për falimentin” i ndryshuar.

Gjykata, pasi dëgjoi palën kërkuese që kërkoi pranimin e kërkesës dhe shpalljen e falimentimit për shoqërinë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., pasi shqyrtoi çështjen në tërësi dhe administroi provat shkresore të lejuara për shqyrtim,

Se kërkuesi Qirjako Kongoli ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një kërkesë, me objekt: “Kërkohet shpallja e falimentit të shoqërisë Certified Solutions “Corporation” sh.p.k.

Nga shqyrtimi gjyqësor, sipas pretendimeve të palës kërkuese, shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k. ushtron veprimtari në ofrim shërbim interneti si “ISP” kombëtar, ofrim shërbim të gjitha shërbimeve të internetit dhe gjithë llojet e shërbimeve që lidhen me të, si VoIP, video, data, ITSP, IPTV, Wi Fi, Max, telefoni zanore në zona rurale e urbane, shërbime me vlerë të shtuar etj. Nga ekstrakti i QKR-së rezulton se kjo shoqëri është themeluar me datë 1.9.2008 dhe përbëhet nga dy ortakë: Batjon Begaj dhe Qirjako Kongoli.

Sipas pretendimeve të kërkuetit, kjo shoqëri ka rezultuar me humbje dhe për këtë arsye, një nga ortakët e saj, i është drejtuar gjykatës duke kërkuar shpalljen e falimentit.

Pala kërkuese pretendoi në gjykim se shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., është në gjendje paaftësie paguese pasi shoqëria është debitore për detyrime tatimore të pashlyera pranë organeve tatimore në shumën 79,397,073 lekë. Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mospagimit nga shoqëria CEZ sh.a. të vlerës së faturuar prej 172,586,787 lekësh.

Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar shpalljen e falimentit të shoqërisë, për shkak të pamundësisë së pagimit të detyrimeve dhe paaftësisë paguese të tij.

Në gjykim, morën pjesë me cilësinë e personit të tretë dhe shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., dhe ortakët tjetër i shoqërisë, Batjon Begaj.

Lidhur me ligjin e aplikueshëm, gjykata çmon se në rastin konkret, ndodhemi përpara një konflikti tregtar dhe legjislacioni që do të aplikohet është sa më poshtë vijon:

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” parashikon se:

“Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi”.

Neni 2 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” parashikon se:



“1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”

Neni 3 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “ Për falimentimin” parashikon se:

“1. Realizimi i procedurave të falimentimit është detyrë e seksioneve tregtare të gjykatës së rrethit (gjykata e falimentimit).

2. Shqyrtimi i çështjeve dhe marrja e vendimeve për procedurën e falimentimit bëhet nga një gjyqtar i vetëm.”

Neni 4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “ Për falimentimin” parashikon se:

“1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe gjykohet në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori, i cili është person juridik, ka vendbanimin ose selinë.

2. Nëse debitori e ka transferuar qendrën e veprimtarisë ekonomike të pavarur në një vend tjetër, përgjegjësia është vetëm e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku ndodhet qendra e re e veprimtarisë së debitorit.

3. Nëse debitori nuk ka seli ose vendbanim në Shqipëri, përgjegjësia i përket seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori ka një degë ose çdo pasuri tjetër.

4. Në rast se një procedurë falimentimi është deklaruar në përgjegjësi të disa seksioneve tregtare të gjykatave të rretheve, përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes e ka seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ku është paraqitur fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, që ka përgjegjësi për të gjykuar një procedurë falimentimi, është gjykata e vetme përgjegjëse për të gjykuar paditë civile, që ngrihen për këtë procedurë falimentimi.”

Neni 16 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “ Për falimentimin” parashikon se:

“1. Të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor, anëtarët e organit

drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta.

2. Në rastin e një personi juridik, çdo anëtar i organit drejtues është i detyruar të kërkojë hapjen e menjëhershme të procedurës së falimentimit, por jo më vonë se 21 ditë nga data kur personi juridik është në gjendje paaftësie paguese, në kuptim të pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji. Këta persona janë personalisht përgjegjës për dëmshpërblimin e kreditorëve nëse kreditorët pësojnë humbje për shkak të mosparaqitjes së kërkesës brenda këtij afati 21-ditor .

3. Nëse kërkesën nuk e paraqesin bashkërisht të gjithë anëtarët e organit drejtues, të gjithë ortakët e thjeshtë të shoqërisë së thjeshtë ose të gjithë likuidatorët, kërkesa pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës se rrethit nëse janë të mjaftueshme dhe bindëse shkaqet e parashtruara për hapjen e procedurës se falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, përpara se të marrë vendimin, dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues, ortakët e thjeshtë ose likuidatorët.

Neni 4 i ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008 parashikon se:

“Në nenin 13, në fund të pikës 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Procedurat për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës.”

Neni 8 i ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008 parashikon se:

Në nenin 17 pika 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Vlerësohen se kanë interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit kreditori, i cili ka ndaj pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror dhe autoritetet fiskale.”

Në bazë të ligjit të sipërcituar procedura e falimentimit hapet për pasuritë e çdo personi përfshirë dhe atë juridik, siç është kërkesa në rastin objekt gjykimi dhe përpara se të jetë kryer ndarja e pasurisë (në rastet e prishjes së shoqërisë dhe futjes së saj në likuidim). Në rastin objekt gjykimi shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k, paraqitet me një status aktiv.

Në nenin 15 të ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht dhe dokumentacioni që kërkohet të paraqitet bashkëngjitur kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.



Në nenin 13/1 të ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.”

Më tej në pikat e tjera të kësaj dispozite ligjvënësi përcakton në mënyrë të shprehur se kush janë shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit, duke mos lënë vend për interpretime apo vlerësime nga ana e gjykatës në lidhje me shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit.

Këto shkaqe janë:

-“*Gjendja e paaftësisë paguese*”, e cila është shkak i përgjithshëm dhe ligji jep nocionin e kësaj “gjendjeje paaftësie paguese”;

-“*Mbingarkesa me borxhe*”, e cila përbën shkak hapjeje të procedurës së falimentimit vetëm për personin juridik (pra jo për çdo subjekt). Dhe në lidhje me këtë shkak ligji jep nocionin e plotë të “mbingarkesës me borxhe”.

Pala kërkuese paraqiti si shkak për kërkimin e saj mbi hapjen e procedurës së falimentimit gjendjen e paaftësisë paguese dhe mbingarkesën me borxhe të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k.

Në rastin konkret, mënyra e kalimit në procedurat e falimentimit për një shoqëri tregtare, parashikohet në ligjin “Për falimentimin” dhe ndryshimet përkatëse që i kanë ndodhur këtij ligji.

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” parashikon se:

“Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi.

Referuar dispozitave të sipërcituara, detyra kryesore e ligjit të falimentimit, është përcaktimi i modaliteteve të cilave duhet t’u nënshtrohet një subjekt tregtar, në momentin kur ai plotëson kriteret ligjore të shpalljes në faliment. Qëllimi kryesor i legjislacionit tregtar që ka të bëjë me falimentimin, është mbrojtja sa më e madhe ligjore që u bëhet kreditorëve në rastet kur një subjekt tregtar ka detyrime financiare ndaj të tretëve, apo përcaktimin në mënyrë të detajuar të një plani riorganizimi për ruajtjen e veprimtarisë tregtare të tij.

Sipas këtyre dispozitave dhe mbështetur në aktet e regjistrimit të kërkuarit, në gjykim rezultoi se shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,

me seli në Tiranë. Në këto kushte, për sa kohë që në gjykim nuk u paraqit ndonjë provë shkresore që të vërtetonte se kjo seli ishte ndryshuar me ndonjë vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të ortakëve të personit juridik, gjykata çmon se është kompetente për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur për shpalljen e falimentimit të kësaj shoqërie.

Neni 16 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” parashikon se:

“1. Të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor, anëtarët e organit drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta.

2. Në rastin e një personi juridik, çdo anëtar i organit drejtues është i detyruar të kërkojë hapjen e menjëhershme të procedurës së falimentimit, por jo më vonë se 21 ditë nga data kur personi juridik është në gjendje paaftësie paguese, në kuptim të pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji. Këta persona janë personalisht përgjegjës për dëmshpërblimin e kreditorëve nëse kreditorët pësojnë humbje për shkak të mosparaqitjes së kërkesës brenda këtij afati 21-ditor .

3. Nëse kërkesën nuk e paraqesin bashkërisht të gjithë anëtarët e organit drejtues, të gjithë ortakët e thjeshtë të shoqërisë së thjeshtë ose të gjithë likuidatorët, kërkesa pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit nëse janë të mjaftueshme dhe bindëse shkaqet e parashtruara për hapjen e procedurës së falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, përpara se të marrë vendim, dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues, ortakët e thjeshtë ose likuidatorët.

Në rastin konkret, duke qenë se pala kërkuese është një nga ortakët e shoqërisë gjykata çmon se kërkuesi, legjitimohet t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar shpalljen e falimentimit të saj.

Pala kërkuese, pretendoi në gjykim se shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., ishte në gjendjen e paaftësisë paguese e në këto kushte, referuar dispozitës së sipërcituar, kjo shoqëri duhet të kalonte në falimentim.

Një fakt i tillë provohet me anë të akteve shkresore të sipërcituara, të administruara në gjykim me cilësinë e provës.

Për të verifikuar dhe vlerësuar pretendimet e palëve në gjykim, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe atë të kërkuar nga ligji, gjykata në seancën e datës 3.3.2014, vendosi në përputhje me



nenin 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, të emërojë ekspertin kontabël Anida Nuri, për të vepruar si administratore e ardhshme e falimentimit, duke e ngarkuar që t’i përgjigjet të gjitha detyrave të përcaktuara shprehimisht në këtë nen.

Administratorja e ardhshme, pasi u njoh me të gjithë dokumentacionin e paraqitur në gjykatë nga palët si dhe me detyrat e lëna, paraqiti një raport më datë 14.5.2014 dhe një shtesë raporti më datë 29.5.2014.

Sipas ekspertës kontabël, konflikti ndërmjet shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., dhe CEZ shpërndarje sh.a. nuk është zgjidhur dhe mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, gjë që përkeqëson gjendjen financiare të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., dhe konkluzioni është se shkak për hapjen e procedurës së falimentimit ndaj shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., ekziston dhe është real.

Në këto kushte, pretendimi i ngritur nga pala kërkuese lidhur me plotësimin e kushteve të falimentimit për këtë shoqëri, është i mbështetur në ligj e në prova sepse:

- Shoqëria ka rezultuar me humbje financiare.

Në lidhje me verifikimin e faktit nëse pasuritë e shoqërisë mbulojnë shpenzimet e falimentimit (të përcaktuara si të tilla në nenin 37 të ligjit 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”), administratorja e përkohshme vëren se pasuritë e debitorit i mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentit.

Gjithashtu gjatë gjykimit të çështjes në datë 27.11.2013, gjykata duke patur parasysh dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8901 datë 23.5.2002 “Për falimentin” i ndryshuar, ka vendosur që të merret masa e sigurimit të padisë për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit në dëm të kreditorëve. Sipas nenit 1 të këtij ligji “fillimi i procedurave të falimentimit synon të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve”. Qëllimi i procedurës së falimentimit është që të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet nëpërmjet likuidimit të të gjithë pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi, ndërmjet arritjes së një marrëveshjeje me synimin kryesor ruajtjen e veprimtarisë së saj. Në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i

ndryshuar, është përcaktuar se “seksioni tregtar i gjykatës së rrethit derisa nuk ka arritur të japë një vendim për hapjen e procedurës së falimentimit ka të drejtë të vendosë mbi pasurinë e debitorit çdo lloj mase që e gjykon të nevojshme për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit”.

Duke qenë se kërkesa e kërkuesit është mbështetur në nenin 13 të ligjit “Për falimentimin”, si dhe referuar faktit se kriteret e kësaj pike rezultojnë të jenë plotësuar për kërkuesin në këtë gjykim, gjykata çmon se kërkesa e paraqitur është e mbështetur në ligj e në prova e si e tillë duhet pranuar, duke vendosur hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k.

Në seancën gjyqësore datë 25.7.2014 gjykata rrëzoi kërkesën e personit të tretë, shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k. “Për pezullimin e gjykimit” me arsyetimin se nuk ndodheshim përpara asnjërit prej rasteve të parashikuara nga neni 297/a i Kodit të Procedurës Civile.

Në seancën gjyqësore datë 25.7.2014 gjykata rrëzoi kërkesën e personit të tretë shoqëria “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., “Për përjashtimin e ekspertës Anida Nuri” me arsyetimin se nuk ndodheshim përpara asnjërit prej rasteve të parashikuara nga nenet 72 dhe 224/a i Kodit të Procedurës Civile.

Referuar nenit 26/4 të ligjit “Për falimentimin” gjykata çmon se administrator i falimentimit do të caktohet ekspertja kontabël e autorizuar, Anida Nuri, në mbështetje të nenit 43 të ligjit të sipërcituar.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, të gjitha pretendimet e tyre tek administratorja e falimentimit duke i njoftuar asaj pretendimet dhe të drejtat e siguruara që kanë mbi pasuritë e “Certified Solutions Corporation” sh.p.k. Gjithashtu, të gjithë personat që kanë detyrime ndaj debitorit, duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit, znj. Anida Nuri.

Një kopje e këtij vendimi, duhet t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, të publikohet në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë palës kërkuese në këtë gjykim dhe duhet të regjistrohet



në të gjithë regjistrat e tjerë ku janë të regjistruar të drejtat e debitorit, shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126 e 308 të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën 12:30 të datës 25.7.2014 të procedurës së falimentimit për shoqërinë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., regjistruar më datë 1.9.2008, me NIPT K8210101Q, me përfaqësues ligjor Venigjar Begaj dhe seli të ndodhur në Tiranë, Mëzez, Kashar, pallati “Alb Konstruksion”, kati i parë, apartamenti 1, Fushë-Mëzez.

3. Emërimin si administratore të falimentimit znj. Anida Nuri, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. licence 16 datë 15.10.2012, me adresë: Rr. “Bab Rexha, 10/1, ap.27, shk.2, Tiranë.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, të gjitha pretendimet e tyre tek administratorja e falimentimit Anida Nuri duke i njoftuar asaj pretendimet dhe të drejtat e siguruara që kanë. Gjithashtu, të gjithë personat që kanë detyrime ndaj debitorit duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit znj. Anida Nuri.

5. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

6. Mbledhja e kreditorëve të subjektit “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., për verifikim mbahet brenda 60 ditëve.

7. Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë dhënë me vendimin nr. 975 akti, datë 27.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Urdhërohet publikimi dy herë i këtij vendimi në internet, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë .

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

12. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Certified Solutions Corporation” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar.

13. Shpenzimet gjyqësore, në ngarkim të palës kërkuese.

14. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 25.7.2014.

Sekretare: **Denisa Xhafa**

Gjyqtar: **Arjan Aliaj**

VENDIM

Nr. 670, datë 13.10.2014

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË ADMINISTRATORIT TË FALIMENTIMIT PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar, e përbërë nga gjyqtari i vetëm: **Dritan CAKA**,

asistuar nga sekretarja Luljeta Kazia, duke vepruar si Gjykatë e Falimentimit, në Tiranë, sot më 13.10.2014, mori në shqyrtim çështjen civile që i përket:

Kërkues: z. Rezar Llukaçej – administrator falimenti, me adresë: rruga “Margarita Tutulani”, pall. “Alb. Millenium”, kati i 2-të, përballë Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë.

Objekti: Shkarkimi nga detyra i administratorit të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

Baza ligjore: Neni 46 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Gjykata, pasi dëgjoi administratoren e falimentit dhe përfaqësuesit e personave të tretë të interesuar në seancë gjyqësore,

VËREN:

1. Me vendimin nr. 6678, datë 9.6.2014 të kësaj gjykatë është vendosur hapja e procedurave të falimentimit për subjektin tregtar “Vila Park-Alb”



sh.p.k. Ky vendim është marrë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kreditori “Banka Alpha Albania” sh.a.

Me të njëjtin vendim ishte emëruar znj. Elida Miti (Dilo) si administratore e falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k., e cila më vonë ka paraqitur kërkesë për shkarkimin e saj nga kjo detyrë. Me vendim të datës 25.7.2014 gjykata ka pranuar kërkesën e znj. Elida Miti (Dilo) për shkarkimin e saj, duke e zëvendësuar atë me administratorin e falimentimit z. Rezar Llukaçej.

2. Me kërkesën objekt shqyrtimi, administratori i falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k., z. Rezar Llukaçej ka kërkuar që të shkarkohet nga kjo detyrë, duke parashtruar si shkak ekzistencën e konfliktit të interesit me palën kërkuese, kreditorin “Banka Alpha Albania” sh.a.

Konkretisht, administratori Rezar Llukaçej parashtron se ka marrëdhënie biznesi me bankën “Alpha Albania” sh.a., pasi ka marrë kredi bankare me afat 20-vjeçar pranë saj dhe është ende në proces shlyerjeje.

Për të vërtetuar këto pretendime administratori i falimentimit ka paraqitur si prova kopje të kredive bankare të miratuara me kontratat nr. 179 rep. e nr. 86 kol., datë 10.1.2008 dhe nr. 180 rep. e nr. 87 kol., datë 10.1.2008.

Administratori i falimentimit parashtron se kërkesa e tij gjen mbështetje në nenin 43/4, pika “a” e ligjit nr. 8901 “Për falimentimin”, ku parashikohet:

“Përveç kriterëve të trajtuara në pikën 3, personat e mëposhtëm nuk mund të caktohen si administratorë falimentimi, sipas këtij ligji:

a) personat, të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me debitorët ose nëpunësit, drejtorët, punonjësit, aksionarët ose kreditorët e debitorit”.

Po kështu, administratori i falimentimit e bazon kërkesën e tij në nenin 46 të të njëjtit ligj, ku parashikohet:

“1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të shkarkojë nga detyra administratorin e falimentimit për arsye të motivuar. Shkarkimi mund të bëhet me kërkesën e vetë administratorit të falimentimit, me kërkesën e komitetit të kreditorëve ose të mbledhjes së kreditorëve. Përpara marrjes së vendimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon shpjegimet e administratorit të falimentimit.

2. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për shkarkimin e tij, administratori i falimentimit ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për rrëzimin e kërkesës për shkarkimin e administratorit, kanë të drejtën e ankimit të veçantë administratori i falimentimit, komiteti i kreditorëve ose kur propozimin për shkarkimin e tij e ka bërë mbledhja e kreditorëve, çdo kreditor falimentimi.”

3. Kërkesën e z. Rezar Llukaçej për shkarkimin nga detyra, gjykata e mori në shqyrtim në mbledhjen e kreditorëve të zhvilluar ditën e sotme 13.10.2014, ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e kreditorit “Banka Alpha Albania” sh.a. dhe disa nga kreditorët e falimentimit. Ndërsa pala debitore “Vila Park-Alb” sh.p.k. nuk u paraqit.

Në këtë seancë përfaqësuesi i palës kërkuese “Banka Alpha Albania” sh.a. deklaroi se e linte në vlerësimin e vetë gjykatës nëse duhet të pranohet ose jo kërkesa e administratorit të falimentimit për dorëheqjen e tij.

4. Gjykata, pasi analizoi kërkesën e administratorit të falimentimit z. Rezar Llukaçej për shkarkimin e tij nga kjo detyrë, vlerëson se ajo duhet të pranohet, duke u bërë zëvendësimi i tij me një administrator tjetër të licencuar.

Konkretisht, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura nga administratori në lidhje me marrëdhëniet e tij të biznesit me shoqërinë “Banka Alpha Albania” sh.a, si kredimarrës i saj, gjykata vlerëson se kërkesa për shkarkim vjen në përputhje me kriteret e neneve 43/4, pika “a” dhe 46 të ligjit nr. 8901 “Për falimentimin”, të cituar më lart.

Pasi u konsultua me listën e administratorëve të falimentimit të publikuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentimit (AMF), gjykata vendosi të caktojë si administrator të ri të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k. z. Ilia Pandi Çeçe.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Zëvendësimin e z. Rezar Llukaçej caktuar në detyrën e administratorit të falimentimit të subjektit shoqëria “Vila Park-Alb” sh.p.k., me z. Ilia Pandi Çeçe, licencuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 21



licence, me adresë: Rruga “Marko Boçari”, nd. 2, hyrja 6, ap. 8, Tiranë, +3554226916 dhe +35542430257,

adresë e-maili: ilacece@yahoo.co.uk.

2. Urdhërohet administratori i falimentimit z. Rezar Llukaçej që t’i dorëzojë administratorit të falimentimit të caktuar rishtazi z. Ilia Çeçe të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e tjera të grumbulluara deri në fazën aktuale të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

3. Urdhërohet dërgimi i një kopjeje të këtij vendimi të gjithë subjekteve të përcaktuara në vendimin nr. 6678, datë 9.6.2014 të kësaj gjykate për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

4. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në të gjitha format me të cilat është publikuar vendimi nr. 6678, datë 9.6.2014 i kësaj gjykate për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vila Park-Alb” sh.p.k.

U shpall në Tiranë, sot më datë 13.10.2014.

Sekretare: **Luljeta Kazia**

Gjyqtar: **Dritan Caka**

VENDIM

Nr. 1596, datë 14.10.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë prej: gjyqtar: Albert Spiro,

asistuar nga sekretarja Xhuljeta Dinaj, më datë 14.10.2014, përfundoi së shqyrtuari çështjen civile me nr. regj. 719 që u përket palëve:

KËRKUES: Shoqëria “Globalmarmi” sh.p.k. Lagjja “1 Maji”, pranë Petroliferës, ish-Uzina e Sodës, Vlorë.

Përfaqësuar nga av. Arjan Isufi.

PERSON I TRETË: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, në mungesë.

OBJEKTI: Ndërprerje e procedurës së falimentimit të vendosur me vendimin nr. 996, datë 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

BAZA LIGJORE: Neni 175, 176, 177 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Në përfundim të gjykimit, palët kërkuan: Pala kërkuese, pranimin e kërkesës. Personi i tretë, në mungesë.

Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet e palës kërkuese, dëgjoi ekspertin e falimentimit, shqyrtoi provat shkresore dhe çështjen në tërësi,

VËREN:

Pala kërkuese, shoqëria “Globalmarmi” sh.p.k., me kërkesën drejtuar gjykatës, kërkon ndërprerjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Globalmarmi” sh.p.k., të vendosur me vendimin nr. 996, datë 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se me vendimin nr. 996, datë 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur:

“1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën 12:00, të datës 16.6.2014 të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Globalmarmi” sh.p.k., me NIPT K 87025202 B me përfaqësues ligjor: Genti Banushi, me seli: lagjja “1 Maji”, ish-Uzina e Sodë PVC, pranë Petrolifera, Vlorë.

3. Emërimin si administrator të falimentimit të z. Luan Muça me nr. licence 11, me adresë: lagjja “Demokracia”, ish-magazinat e NTAN, Tepelenë.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi të gjitha pretendimet e tyre tek administratori i falimentimit, duke i njoftuar pretendimet dhe të drejtat e siguruar që kanë mbi pasuritë e personit të tretë në këtë gjykim. Gjithashtu të gjithë personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë “Globalmarmi” sh.p.k. duhet t’ia paguajnë administratorit të falimentimit.

5. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e vendimit.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e vendimit.

7. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Globalmarmi” sh.p.k. në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Urdhërohet publikimi dy herë i këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në faqen zyrtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë D.R. Tatimeve Vlorë si dhe publikimi i vendimit të shkurtuar në dy gazeta kombëtare.



9. Një kopje e vendimit t'u dërgohet: ZVRPP Vlorë, të gjitha bankave të nivelit të dytë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.

Pas ardhjes në dijeni të këtij vendimi, nga ana e subjektit kërkues, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, u kërkua ndërprerja e procedurës së falimentimit, pasi shkaqet për hapjen e kësaj procedure nuk ekzistonin më.

Duke iu referuar vendimit gjyqësor, rezulton që kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Globalmarmi” sh.p.k. është paraqitur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë dhe shkaku ka qenë moszhvillimi i aktivitetit për më shumë se dy vjet.

Kreditori i vetëm i shoqërisë sipas vendimit gjyqësor ka qenë vetëm Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për një shumë 70 209 lekë. Pas ardhjes në dijeni të vendimit gjyqësor me të cilin është çelur procedura e falimentimit, përfaqësuesi i debitorit ka shlyer detyrimet ndaj kreditorit të vetëm.

Në nenin 176 të ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008 “Për falimentimin”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Procedura e falimentimit ndërpritet me kërkesën e debitorit, kur ky, pasi përfundon periudha e njoftimit, paraqet një deklaratë miratimi të të gjithë kreditorëve të falimentimit, që kanë depozituar pretendime për ndërprerjen e kësaj procedure. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, sipas diskrecionit të saj, vendos për kreditorët, kërkesat e të cilëve janë kundërshtuar nga debitori ose administratori i falimentimit dhe për kreditorët me të drejtë riparimi të veçantë, lidhur me kërkesat e miratimit të kreditorëve ose të mjeteve të sigurisë që ata duhet të paraqesin.

Procedura e falimentimit mund të ndërpritet me kërkesën e debitorit edhe përpara mbarimit të afatit të depozitimit nëse gjykata nuk njeh kreditorë të tjerë përveç kreditorëve për të cilët debitori ka paraqitur deklaratat e miratimit prej tyre”.

Duke iu referuar rrethanave të faktit të rezultuara të provuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka rezultuar se deri në datë 16.9.2014, pranë ekspertit të falimentit të caktuar me vendimin nr. 996, dt. 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i vetmi kreditor ishte Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë në masën prej 70 209 lekë. Kjo debi që kishte shoqëria ndaj DRT Vlorë, me autorizimin e ekspertit të falimentit z. Luan Muça, është paguar prej shoqërisë, fakt ky i provuar me dëftesën e pagesës pranë bankës “Societe Generale Albania”, dega Vlorë.

I thirrur prej gjykatës, në seancën e datës 26.9.2014, eksperti i falimentit z. Luan Muça, deklaroi se deri në dt. 16.9.2014, që është edhe afati 3 mujor i parashikuar në ligj për të bërë të mundur paraqitjen e të drejtave nga kreditorë të ndryshëm të subjektit ndaj të cilit është kërkuar çelja e procedurës së falimentit, nuk rezultonte të ishte paraqitur pranë tij asnjë kreditor tjetër, veç DRT Vlorë, për të cilën tashmë rezultonte e shlyer debia prej 70 209 lekësh.

Gjithashtu nga aktet, rezulton gjithashtu se nga ana e subjektit kërkues, shoqëria “Globalmarmi” sh.p.k., në dt. 7.7.2014, bazuar në nenet 175,176,177 e vijues të ligjit nr. 9919 datë 19.5.2008 i ndryshuar, është depozituar edhe një kërkesë pranë DRT Vlorë, me objekt: “Dhënien e miratimit për ndërprerjen e procedurës së falimentimit të vendosur me vendimin nr. 996 datë 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

Pavarësisht periudhës 3 mujore të kaluar, që nga momenti i depozitimit të kërkesës pranë DRT Vlorë për dhënien e miratimit për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, dhe faktit se për disa herë radhazi, edhe pse u njoftua prej gjykatës për të bërë të mundur praninë e saj gjatë këtij gjykimi me cilësinë e personit të tretë, nga ana e DRT Vlorë, edhe pse nga aktet rezultoi se debia që kishte subjekti ndaj saj ishte paguar, nuk u paraqit në këtë gjykim, duke mos shprehur qëndrimin e saj në lidhje me këtë kërkesë.

Qëndrimi i saj, indirekt u evidentua nëpërmjet deklaratimit të dhënë përpara gjykatës nga eksperti i caktuar për falimentin, z. Luan Muça, i cili u shpreh se në përfundim të periudhës tremujore të njoftimit, subjekti i vetëm kreditor, DRT Vlorë, pas realizimit të pagesës së detyrimit prej 70 209 lekësh nga ana e shoqërisë “Globalmarmi” sh.p.k.. Si rrjedhojë, heshtja e DRT Vlorë, në lidhje me këtë fakt, nënkupton se nga ana e këtij institucioni nuk evidentohen pretendime të tjera, pasi nëse të tilla do të kishin ekzistuar, ato do të ishin pasqyruar pranë z. Luan Muça brenda afatit tremujor të njoftimit.

Nga vendimi gjyqësor nr. 996 datë 16.6.2014 bazuar dhe në aktin e ekspertimit të përgatitur nga administrator i caktuar nga gjykata, rezulton e provuar që gjykata nuk njeh kreditor tjetër të shoqërisë, pasi nga akti i ekspertimit rezulton që, shoqëria “Globalmarmi” nuk ka detyrime ndaj të tretëve. Duke qenë se detyrimet e shoqërisë ndaj të



vetmit kreditor janë shlyer, ky kreditor, duke mos paraqitur pretendime të tjera brenda afatit 3 mujor, indirekt ka pranuar dhe ka dhënë miratimin e tij, për ndërprerjen e procedurës së falimentimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka rezultuar se gjendja financiare dhe aftësia paguese e kësaj shoqërie, e cila ka si aktivitet kryesor tregtar përpunimin e mermerit, janë të tilla që lejojnë vijimin e aktivitetit tregtar.

Veç sa më sipër, ka rezultuar se, shoqëria “Globalmarmi” sh.p.k. disponon dhe ka në pronësi tokë dhe ndërtesë në vlerën 14.666.158 lekë, ku edhe është vendosur zhvillimi i aktivitetit tregtar. Gjithashtu ka rezultuar, duke iu referuar aktit të ekspertimit se shoqëria nisur nga kjo gjendje dhe situatë faktike, mund të mbulojë shpenzimet që rrjedhin nga falimentimi.

Gjykata vlerëson se pala kërkuese duhet të paguajë dhe shpenzimet gjyqësore duke përfshirë dhe ato për ekspertin e falimentimit.

Përfundimisht gjykata vlerëson se kërkesa duhet të pranohet për shkak se bazohet në nenet 175,176,177 e ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar dhe u provua në gjykim nga pohimet e palës kërkuese dhe të ekspertit të falimentimit si dhe provat shkresore të shqyrtuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata në bazë të neneve 306-310 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së palës kërkuese, shoqëria “Globalmarmi” sh.p.k..
2. Ndërprerjen e procedurës së falimentimit të vendosur me vendimin nr. 996, datë 16.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
3. Urdhërohet publikimi i vendimit për ndërprerjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Globalmarmi” sh.p.k. në Buletinin e Njoftimeve Publike.
4. Urdhërohet publikimi dy herë i këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në faqen zyrtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë D.R. Tatimeve Vlorë si dhe publikimi i vendimit të shkurtuar në dy gazeta kombëtare.
5. Një kopje e vendimit t’u dërgohet: ZVRPP Vlorë, të gjitha bankave të nivelit të dytë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shpenzimet gjyqësore, në ngarkim të palës kërkuese.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë duke filluar afati për palën në mungesë nga data e komunikimit të vendimit.

U shpall në Vlorë, më 14.10.2014

Sekretare: **Xhuljeta Dinaj**

Gjyqtar: **Albert Spiro**

VENDIM

Nr.1758, datë 6.11.2014

NE EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga: Mirela Mishgjoni –gjyqtare,

asistuar nga sekretare e seancës Danaida Zanaj, në Vlorë, më datë 6.11.2014, ora 11:15, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, shqyrtoi çështjen civile nr.2417, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k, me seli në Vlorë, lagja “11 Janari”, rajoni nr.5, përfaqësuar në bazë të prokurës së përgjithshme nr. 2561/1706, datë 3.9.2014, nga av. Emiljano Hajrulla, anëtar i Dhomës së Avokatisë Vlorë, me nr. 4063 licence, nr. L06313202K NIPT-i.

OBJEKTI: Çelje e procedurës së falimentit.

BAZA LIGJORE: Neni 11, 13, 14, 15, 18, 21, 22/2, 74, 75, 180-232 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, ndryshuar me ligjin nr. 9919 datë 19.5.2008.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën, dëgjoi përfaqësuesin e kërkuetit shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k., av. Emiljano Hajrulla që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe hartimin e një plani riorganizimi,

VËREN:

Me kërkesën objekt gjykimi kërkueti, shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k. ka kërkuar çeljen e procedurës së falimentimit, sigurimin e pasurive të kërkuetit, caktimin e një administratori të përkohshëm dhe hartimin e një plani riorganizimi.

Rezulton se kërkueti, shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k. me administrator znj. Bukurie Haxhiraj, është shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datën 27.10.2006 si person juridik me objekt ushtrimin e aktivitetit tregtar të import-eksportit, prodhimin e birrës, lëngjeve të frutave, tregtimit të tyre me shumicë



dhe pakicë etj. Shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k është pajisur me certifikatën tatimore me nr. K67227203A NIPT-i. Rezulton se shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k. prej datës së regjistrimit vazhdon të ushtrojë të njëjtin aktivitet dhe ka status aktiv.

Rezulton se në ushtrim të aktivitetit të saj tregtar, shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k. ka marrë disa kredi nga shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a, kredi të cilat janë të pasqyruara në kontratat e kredive bankare nr. 1118/666, datë 28.2.2012, e siguruar me kontratën e hipotekës nr. 1118/664, datë 28.2.2012; marrëveshjen siguroese nr. 1113/661, datë 28.2.2012; marrëveshjen siguroese dhe pengu mbi kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri nr. 1114/662, datë 28.2.2012; marrëveshje siguroese (kolateral specific) nr.1115/663, datë 28.2.2012; “kontratë e huas në llogarinë rrjedhëse nr.2254/681, datë 5.6.2007”, ndryshuar me kontratën nr.1117/665, datë 28.2.2012.

Rezulton se në momentin e paraqitjes së kërkesës objekt gjykimi, shuma e mbetur e kredisë, sipas dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi, në monedhën euro është 8,659,284 (tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) euro ndërsa shuma e mbetur e kredisë në monedhën lekë (overdraft) është 157,991,124 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e njëzetë e katër) lekë. Rezulton se pagesa e kësteve mujore të kredisë është 11,917,000 lekë + 7,051,500lekë.

Për shkak të mospagesës në afat të kësteve të përcaktuara në kontratat e kredisë bankare, nga ana e kreditorit është kërkuar ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë, pra të kontratave të kredive bankare përkatëse. Me vendimet nr.4878, datë 18.9.2014, dhe nr.4879, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kërkesën e kreditorit, janë vendosur lëshimi i urdhrave të ekzekutimit për kontratat e kredive bankare nr.1118/666, datë 28.2.2012, dhe “Kontratën e huas në llogarinë rrjedhëse nr.2254/681, datë 5.6.2007”, ndryshuar me kontratën nr.1117/665, datë 28.02.2012, të lidhura midis shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a., në cilësinë e kredidhënësit dhe shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., në cilësinë e kredimarrësit.

Mbi bazën e titujve ekzekutivë, urdhrave të ekzekutimit dhe kërkesave të kreditorit, është kryer regjistrimi i procedurave përbarimore nr.451 dhe

nr.452, pranë shoqërisë përbarimtare private “E.P.S.A” sh.p.k.

Sipas lajmërimeve për ekzekutim vullnetar të shoqërisë përbarimtare private “E.P.S.A”, sh.p.k. nr.10135, datë 8.10.2014 dhe nr. 10136, datë 8.10.2014, shuma që i detyrohet shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k. kredidhënësit, shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., janë 9,541,796 (nëntë milion e pesëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) euro dhe 163,004,627 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë.

Duke pretenduar paaftësi paguese për shlyerjen e detyrimeve ndaj kreditorëve të saj, kërkuesja, shoqëria “A&B GRUP” sh.p.k., ka kërkuar çeljen e procedurës së falimentit dhe njëkohësisht ka kërkuar sigurimin e pasurisë, me qëllim për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit.

Baza ligjore që i shërben gjykatës për zgjidhjen e çështjes:

- Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” parashikon: “Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi”.

- Neni 2 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” parashikon: “1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij . 2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”

- Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak. 2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat. 3. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, paaftësia paguese në një të ardhme të afërt përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori ndodhet në gjendjen e



paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit. 4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë. 5. Kriteret dhe mënyrat e përlogaritjes së treguesve ekonomikë, mbi të cilët fillojnë procedurat e falimentimit, caktohen nga Këshilli i Ministrave...”.

- Neni 14/1 i ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë tri vjeçare...”.

- Neni 18 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon: “1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të emërojë një specialist të veprorë si administrator i përkohshëm ose i ardhshëm i debitorit dhe i ngarkon atij këto detyra: a) të verifikojë nëse është real shkak për hapjen e procedurës së falimentimit; b) të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit; c) të verifikojë nëse është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë; ç) të verifikojë nëse është mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori. 2. Gjatë shqyrtimit të çështjes, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, mund të vendosë masa sigurimi mbi pasurinë e debitorit, sipas nenit 21 të këtij ligji. 3. Shqyrtimi i çështjes nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duhet të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit. 4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: ... c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit.”

- Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon: “1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet

e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi përhapjen e procedurës së falimentimit përmban : a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; ç) të dhënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës. 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit”.

Në përfundim, pas analizës së faktit, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, ajo duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Fillimi, në rrugë gjyqësore, i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit: a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim ose b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

Legjitimitimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit, e gëzon kreditori, debitori si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale tri vjeçare. Në rastet kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vetë subjekti debitor, ky i fundit duhet t'i evidentojë gjykatës listën e pasurive dhe të ardhurave, listën e kreditorëve me vlerat respektive të detyrimit. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata arrin në përfundimin se pala kërkuese legjitimohet të



paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e debitorit në procedurën e falimentimit.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 18 të ligjit, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë "A&B GRUP" sh.p.k., Gjykata emëroi si administrator të përkohshëm të falimentimit z.Rrapo Xhaferaj, të cilit iu caktua si detyrë të verifikojë ekzistencën e shkakut apo shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtëm të gjendjes së paaftësisë paguese të subjektit apo/dhe mbingarkesës së tij me borxhe, të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, të verifikojë nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregtare të debitorit.

Nga raporti i paraqitur nga administratori i përkohshëm i falimentimit, rezultuan këto përfundime: Ekzistenca e shkakut të çeljes së procedurës së falimentimit të shoqërisë "A&B GRUP" sh.p.k. është real. Nga provat, sipas aktit, rezulton se shoqëria "A&B GRUP" sh.p.k. është në gjendjen e paaftësisë paguese; pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit; ekziston domosdoshmëria e marrjes së masave të sigurimit të pasurisë; debitori ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë tregtare por kjo mundësi mund të rezultojë vetëm pas fillimit të procedurës së falimentimit, pas marrjes së të gjitha të dhënave të domosdoshme dhe hartimit nga ana e administratorit të falimentimit të një plani të detajuar riorganizimi, plan i cili duhet të jetë real në mënyrë që të përmirësojë treguesit financiarë, të sigurojë pagesat e kreditorëve dhe vazhdimin e aktivitetit tregtar të debitorit.

Nga interpretimi i dispozitave të ligjit në harmoni me rrethanën e faktit, Gjykata vëren se debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese. Nga analiza e tërësisë së provave të administruara në gjykim, rezulton se shoqëria "A&B GRUP" sh.p.k., është në pamundësi financiare, të ardhurat e së cilës nuk mjaftojnë për të paguar detyrimet ndaj kreditorëve, të cilat janë maturuar prej kohësh.

Pasuria e shoqërisë "A&B GRUP" sh.p.k., sipas aktit të ekspertimit dhe provave shkresore, rezulton që të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentimit. Rezulton se asetet e shoqërisë (aktivet afatgjata materiale) mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe arrijnë të shlyejnë

detyrimet ndaj kreditorëve si edhe kamatëvonesa deri në 25% të detyrimit. Sipas pasqyrave financiare të vitit 2013 dhe bilancit paraprak të datës 30.9.2014, hartuar në kuadër të këtij gjykimi, pasuritë e shoqërisë të vlerësuara në vlerën neto të realizueshme dalin me tregues pozitiv edhe mbas shlyerjes së kreditorëve.

Përsa u takon kreditorëve dhe debitorëve, në listat në të cilat është bazuar raporti i vlerësimit, paraqiten si më poshtë vijon: Lista e kreditorëve, datë 30.9.2014. Vlera totale e detyrimit të shoqërisë "A&B GRUP" sh.p.k. është në shumën 1,682,193,985 lekë, ndërsa lista e debitorëve, datë 30.9.2014. Vlera totale e kredisë së shoqërisë "A&B GRUP" sh.p.k është në shumën 15,487,068 lekë.

Në përfundim të hetimit gjyqësor provohet se shoqëria "A&B GRUP" sh.p.k., është në pamundësi financiare për të shlyer detyrimet ndaj kreditorëve, të cilat rezultojnë tashmë të maturuara, rrethanë kjo që vërteton ekzistencën e paaftësisë paguese të saj. Sa më sipër, provohet ekzistenca e njërit prej kushteve të hapjes së procedurës së falimentimit në kuptim të nenit 13/2 të ligjit "Për falimentimin".

Në lidhje me nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, me vendimin nr.2417 akti, datë 21.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur marrjen e masave të sigurisë mbi çdo lloj pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë "A&B GRUP" sh.p.k., përfshirë llogaritë bankare të shoqërisë dhe administratorëve, kuotat e shoqërisë duke urdhëruar kufizimin e përgjithshëm të disponimit mbi këto pasuri nga kërkuarisi; duke urdhëruar pezullimin e të gjitha procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm të çdo të drejte të siguruar, pra duke urdhëruar pezullimin e çdo lloj veprimi përmbarimor mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë deri në përfundim të këtij gjykimi. Gjithashtu, gjykata ka emëruar si administrator të përkohshëm falimentimi shtetasin Rrapo Petref Xhaferaj.

Në lidhje me verifikimin e mundësisë për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori, u provua se shoqëria "A&B GRUP" sh.p.k., ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë tregtare, por kjo mundësi realizohet vetëm pas fillimit të procedurës së falimentimit, pas marrjes së të gjitha të dhënave të domosdoshme dhe hartimit nga ana e administratorit të falimentimit apo debitorit të një plani të detajuar riorganizimi, plan i cili duhet të jetë



real, në mënyrë që të përmirësojë treguesit financiarë, të sigurojë pagesat e kreditorëve dhe vazhdimin e aktivitetit tregtar të debitorit.

Sipas parashikimeve të neneve 180 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, gjykata çmon se ky plan, në kushtet kur nuk i është paraqitur gjykatës nga debitori së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit, mund të paraqitet pas fillimit të procedurës së falimentimit, pra gjatë procedurës së falimentimit.

Bazuar në nenet 182, 183, 184 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, plani i riorganizimit duhet të përbëhet nga pjesa paraqitëse dhe analiza e hollësishme. Në pjesën paraqitëse të planit të riorganizimit duhet të përshkruhen masat e marra pas fillimit të procedurës së falimentimit, për të krijuar bazat për tjetërsimin e të drejtave të palëve të përfshira. Pjesa paraqitëse duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e tjera, si dhe pasojat e planit, të cilat janë të rëndësishme për vendimin e kreditorëve për ta pranuar planin, si dhe për miratimin e tij nga gjykata. Ndërsa në pjesën arsyetuese të planit të riorganizimit përcaktohet si do të tjetërsohen, nëpërmjet planit, të drejtat e palëve të përfshira.

Rezulton se debitori së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit ka shfaqur vetëm vullnetin për hartimin e një plani riorganizimi, por nuk ka paraqitur një të tillë, që të mund të shqyrtohej nga gjykata.

Sa më lart dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e një prej shkaqeve të çeljes së procedurës së falimentimit, Gjykata, në bazë të neneve 18/4/c dhe 26 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, vendos pranimin e kërkesës dhe hapjen në orën 11:20 minuta, të datës 6.11.2014 të procedurës së falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k.

Gjithashtu gjykata do të urdhërojë edhe marrjen e masave të parashikuara në ligj për mbarëvajtjen e procedurave të falimentimit duke emëruar si administrator të falimentimit z. Rrapo Xhaferaj, i cili ka kryer deri tani detyrën e administratorit të përkohshëm të falimentimit, emërim që është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve

të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k. për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të neneve 26, 29, 30, 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet publikimi dhe njoftimi i këtij vendimi gjithë subjekteve të parashikuara në ligj, sipas mënyrave të përcaktuara në këtë ligj.

Gjykata do të urdhërojë publikimin e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike; një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit; një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar); një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k. t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë; një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k. t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar; urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar.



Gjithashtu gjykata, bazuar në nenin 212 të Kodit të Procedurës Civile, me pranimin e kërkesës objekt gjykimi do të ligjërojë vendimin nr.2417 akti, datë 21.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për sigurimin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata në bazë të neneve 126, 212, 306 - 310 të Kodit të Procedurës Civile, neneve 1, 2, 13, 14, 18, 21, 26, 43, 180 e vijues të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës së kërkuetit, shoqëria “A&B GRUP”, sh.p.k.

- Hapjen në orën 11:20 minuta, të datës 6.11.2014, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., me administrator Bukurie Haxhiraj, me seli në Vlorë, adresa: Lagja “11 Janari”, rajoni nr.5, me objekt të ushtrimit të aktivitetit tregtar “Import-eksport, prodhimin e birrës, lëngjeve të frutave, tregtimit të tyre me shumicë dhe pakicë etj”.

- Emërimin si administrator të falimentimit, për shoqërinë “A&B GRUP” sh.p.k. të z.Rapo Petref Xhaferaj, administrator falimenti i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, nr.22 licence, datë 2.5.2013, me adresë: Lagja “Hajro Çakerri”, rruga “Sulejman Delvina”, pallati pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kati I.

- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., të paraqesin pranë administratorit të falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

- Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratorit të falimentimit z.Rapo Xhaferaj.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

- Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë dhënë me vendimin nr.2417 akti, datë 21.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP”, sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

- Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar.

- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuetit, shoqërisë “A&B GRUP” sh.p.k.

- Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

Vlorë, më 6.11.2014

Sekretare: **Danajda Zanaj**

Gjyqtare: **Mirela Mishgjoni**

**NJOFTIM****Nr. 1444, datë 20.3.2015****PËR SHPALLJEN E KONKURSIT
PUBLIK ME OBJEKT “RESTAURIMI I
KALASË SË GJIROKASTRËS”**

1. Institucioni Ministria e Kulturës njofton subjektet e interesuara të licencuara për restaurim të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkursin publik të shpallur nga ky institucion.

2. Objekti që do të restaurohet është “Restaurimi i Kalasë së Gjirokastrës” dhe ndodhet në Gjirokastrë.

3. Fondi limit i vënë në dispozicion është 11.666.666 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).

4. Data e përfundimit të restaurimit, 20 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

5. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 06.4.2015, ora 11:00, në Zyrën e protokollit të institucionit. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.

6. Kandidatët e interesuar mund të inspektojnë dokumentet e restaurimit, nga ora 12:00 deri 14:00, pranë Drejtorisë Juridike dhe Marrëveshjeve.

7. Dokumentet standarde të restaurimit mund të tërhiqen pranë institucionit në bazë të kërkesës me shkrim dhe kundrejt një çmimi prej 2000 lekë, nga ora 12:00 deri 14:00.

8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde të restaurimit, të miratuara për këtë qëllim.

9. Ofertat do të shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit në datë 06.4.2015, ora 11:00 në Ministrinë e Kulturës, salla e mbledhjeve.

10. Përfaqësues të autorizuar me shkrim të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2015